

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI: MASTER PEDAGOGJI E PËRGJITHSHME



TEZA MASTER

**ROLI I PEDAGOGUT DHE ORGANEVE DREJTUESE TË SHKOLLËS
NË PARANDALIMIN E DUKURIVE NEGATIVE NË SHKOLLË**

Mentori:

Prof. Dr. Januz Dërvodeli

Kandidati:

Behar Kryeziu

Prishtinë, Janar 2022

FAKULTETI I EDUKIMIT

Studimet Master

PROGRAMI: MASTER PEDAGOGJI E PËRGJITHSHME

TEZA MASTER

E paraqitur nga:

Behar Kryeziu

Në kërkim të gradës shkencore

Master

Mentori: Prof. Dr. Januz Dërvodeli

Roli i pedagogut dhe organeve drejtuese të shkollës në parandalimin e dukurive negative
në shkollë

Mbrohet para komisionit vlerësues të përbërë nga:

Mentori: Prof. Dr. Januz Dërvodeli _____ mentor

Dr. Demë Hoti _____ kryetar

Dr. Adhurim Rasimi _____ anëtar

Prishtinë, Janar 2022

© [2022] - [*Behar Kryeziu*]

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

FALËNDERIM

Falënderim dhe respekt kam për profesorin udhëheqës mentorin tim, Prof. Dr. Januz Dërvodelin për ndihmën e ofruar dhe udhëzimet të cilat ndihmuan që ky punim të jetë sa më akademik dhe profesional, po ashtu falenderim kam edhe për anëtarët tjerë të komisionit në përbërje prej Prof. Dr. Demë Hoti dhe Prof. Adhurim Rasimi, njëherit falënderoj të gjithë profesorët e departamentit të pedagogjisë të cilët kanë kontribuar në formësimin tim intelektual dhe njerëzor. Falënderim kam për familjen dhe kolegët që më dhanë mbështetje dhe bashkëpunuan gjatë gjithë kohës së studimeve. Jam mirënjohës që para një komisioni profesional të mbroj temën dhe njohuritë e fituara që do të më shërbejnë gjatë gjithë jetës sime.

Përmbajtja

Abstrakti	i
Abstract	ii
KAPITULLI I HYRJJE	1
1.1 Prezantimi i problemit.....	2
1.2. Objektivat e studimit.....	3
1.3 Rëndësia e studimit.....	3
KAPITULLI II	
SHFLETIMI I LITERATURËS	4
2.1. Nocionet themelore, përkufizimi i nocioneve: dukuri negative, duhan, drogë, alkool dhe sjellje devijante në shkollë.....	4
2.2. Dukuritë negative që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve.....	7
2.3. Shërbimi pedagogjik.....	8
2.4 Detyrat e pedagogut të shkollës.....	9
2.5 Roli i pedagogut të shkollës.....	10
2.6 Mungesa e stafit pedagogjik në shkolla dhe sfidat në sistemin e arsimit parauniversitar ..	14
2.7. Detyrat e tjera dhe objektivat e shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë.....	16
2.8 Disa detyra specifike të pedagogut dhe të psikologut në shkollë.....	17
2.10 Realizimi i punës edukativo-mësimore.....	18
2.11 Puna me mësimdhënës.....	19
2.12 Puna me nxënës.....	19
2.13 Puna hulumtuese.....	20
2.14 Bashkëpunimi me organet profesionale në shkollë.....	20
2.15 Bashkëpunimi me drejtorin.....	20
2.16 Roli i organeve drejtuese të shkollës.....	21
2.17 Teoria dhe praktika e bashkëpunimit të shkollës me familjen.....	22
2.18 Praktikrat e bashkëpunimit të shkollës dhe familjes në përballimin e dhunës ndërmjet nxënësve.....	23
2.19 Studimet për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë.....	25
2.20 Studimet për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.....	28
2.21 Faktorët e dhunës.....	29
2.22 Llojet e dhunës.....	29
2.23 Faktorët me ndikim tek dhuna.....	29

2.24 Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna sipas juridiksionit të Republikës së Kosovës.....	30
KAPITULLI III	32
III. METODOLOGJIA	32
3.1 Qëllimi i hulumtimit	32
3.2 Metodat e hulumtimit.....	32
3.3 Hipoteza e hulumtimitHipoteza kryesore e hulumtimit :.....	33
3.4 Popullacioni dhe mostra.....	33
3.5 Instrumentet e hulumtimit.....	33
3.6 Dizajni i hulumtimit.....	34
3.7 Përpunimi statistikor i të dhënave.....	34
3.8 Nxierja e perfundimeve dhe rekomandimeve.	35
3.10 Kufizimet e studimit	35
KAPITULLI IV.....	36
IV. REZULTATET E PRITURA.....	36
KAPITULLI V	46
KONKLUZIONE.....	48
REKOMANDIMET.....	50
Referencat.....	51
Shtojca-instrumentet e hulumtimit-pyetësorët	56
Pyetësor për mësimdhënësit.....	56
Pyetësori për prindër	60
Pyetësor për nxënës.....	66
Sa mendoni se shprehjet e mëposhtme janë shkaktarë për shfaqjen e dhunës në shkollë.	
Shprehni mendimin tuaj me X në shkallën e mëposhtme:.....	70

Abstrakti

Hulumtimi i realizuar mbi temën “Roli i pedagogut dhe organeve drejtuese lidhur me parandalimin e dukurive negative tek nxënësit”. Ky hulumtim ka për qëllim të tregoj se cilët janë faktorët e shfaqjes së sjelljes negative në shkolla: faktorë të lidhur me familjen, me menaxhmentin në shkollë, mjedisin e shkollës, me influencën e internetit dhe filmave të dhunshëm në shprehjen e sjelljeve të dhunshme dhe përdorimin e duhanit, alkoolit, drogave etj. Ky hulumtim ishte i llojit kuantitativ dhe kishte 200 pjesëmarrës dhe prej tyre 100 nxënës, 54 prindër dhe 46 mësimdhënës /staf drejtues i shkollës. Ky hulumtim u realizua me anë të instrumentit matës pyetësorit. Realizimi i këtij hulumtimi u bë me anë të tri pyetjeve hulumtuese.

H1: “Ekziston një ndërlidhje negative në mes të mungesës së pedagogut dhe psikologut në shkollë, ndikimit të organeve drejtuese të shkollës në parandalimin e përfshirjes së nxënësve në dukuritë negative dhe abuzimit të tyre nga familjet”, hipotezë kjo e analizuar përmes analizës së korealcionit të Pearsonit dhe ka rezultuar si e saktë. Po ashtu mënyra e edukimit është e ndërlidhur me variablën e mungesën e pedagogut dhe psikologut në shkollë.

H2: “Ekziston një ndërlidhje negative në mes të marrëdhënieve të dobëta prindër – fëmijë. përdorimit të lojërave kompjuterike të dhunshme dhe rritjes së dhunës tek nxënësit”, hipotezë kjo e analizuar përmes analizës së korealacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar poashtu e saktë sepse nëse kemi marrëdhënie të dobëta prindër- fëmijë atëherë rritja e sjelljeve negative tek nxënësit është e pashamangshme.

H3: Nxënësit meshkuj shfaqin më shumë dhunë fizike se sa vajzat, hipotezë kjo e cila është analizuar përmes analizës së t-testit dhe ka rezultuar se kemi dallime gjinore në shfaqjen e dhunës tek femrat dhe meshkujt dhe si rezultat i kësaj analize kemi këto të dhëna ku meshkujt kanë predispozita më të larta për shfaqje të dhunës se sa femrat.

Fjalët kyçe: Faktor, dhunë, duhan, alkool, nxënës, mësimdhënës, drejtor, pedagog, psikolog etj.

Abstract

Research conducted on the topic "The role of the pedagogue and governing bodies in preventing negative phenomena in students." This research aims to show what are the factors of the occurrence of negative behaviors in schools: factors related to family, school management, school environment, the impact of the Internet and violent movies on the expression of violent behaviors and the use of tobacco, alcohol, etc. . drugs etc. This research was of quantitative type and had 200 participants and of them 100 students, 54 parents and 46 teachers / school management staff. This research was conducted using the measuring instrument of the questionnaire. The realization of this research was done through three research questions. H1: "There is a negative correlation between the absence of a teacher and a school psychologist, the influence of school governing bodies in preventing the involvement of students in negative phenomena and their abuse by families", this hypothesis is analyzed through Pearson correlation analysis. and turned out to be correct. Also the way of education is related to the variable of absence of pedagogue and psychologist in school. H2: "There is a negative correlation between poor parent-child relationships. the use of violent computer games and the increase in violence among students ", this hypothesis was analyzed through Pearson correlation analysis and also proved to be correct because if we have weak parent-child relationships then the increase of negative behaviors in students is inevitable. . H3: Male students exhibit more physical violence than girls, a hypothesis which was analyzed through t-test analysis and it turned out that we have gender differences in the occurrence of violence in children and men and as a result of this analysis we have these data. where men have higher predispositions to display violence than women.

Keywords: Factor, violence, tobacco, alcohol, student, teacher, principal, pedagogue, psychologist, etc.

KAPITULLI I HYRJJE

Shkolla ka filluar të funksionojë si një institucion i ngritur enkas për tu marrë me arsimimin dhe edukimin e fëmijëve, gjë të cilën prindërit nuk kanë mund ta kryejnë për një varg arsyesh: mungesë kompetence, mungesë kohe, kosto e lartë, etj. Shkolla si institucion është zhvilluar në vazhdimësi. Përgjatë zhvillimit të saj si institucion shkolla ka ardhur duke u ndërgjegjësuar gjithnjë e më shumë për pamundësinë e përballimit veçmas të detyrës së edukimit. Bashkëpunimi efektiv mes shkollës dhe familjes në parandalimin e dukurive negative siç janë dhunës ndërmjet nxënësve, sjelljet devijante, përdorimi i alkoolit, duhanit dhe substancave narkotike duhet të ndërtohet mbi një vizion të qartë. Nuk mund të imagjinohet se mund të arrihen rezultate gjatë këtij bashkëpunimi nëse shkolla nuk ka një strategji të përcaktuar veprimi në këtë drejtim, strategji gjithëpërfshirëse kundër dukurive negative ndërmjet nxënësve në shkollë, me të cilën nënkuptojmë përfshirjen e nxënësve, familjes dhe shkollës. Dukuritë negative si dhuna dhe huliganizmi, ngacmimet mes nxënësve, sulmet ndaj mësimitdhënësve, përdorimi i armëve dhe dëmet që shkaktohen në mjediset edukativo-arsimore, tashmë janë bërë problem shqetësues në shkollat tona. Këto situata janë brengosëse për nxënësit, prindërit, mësimitdhënësit dhe për shoqërinë në tërësi. Dhuna manifestohet me një llojllojshmëri të gjerë të sjelljeve agresive që ndodhin në mes të nxënësve, prej zgjidhjes së konfliktit nëpërmjet kërcënimit, shtyrjeve e goditjeve me grushte e deri te përdorimi i armëve ndaj njëri-tjetrit me ç'rast njëra palë është ushtruesi i dhunës, kurse pala tjetër është viktima. Kryerësit e këtyre veprave janë kryesisht të rinj. Fakti që ky fenomen është i pranishëm jo vetëm në shkollat e mesme por edhe në shkollat fillore është edhe më shqetësues. Fëmijët mësojnë të rriten nga mjedisi, ambiente apo rrethana të dhunshme ndikojnë shumë që fëmijët të mësojnë që të bëhen të dhunshëm, e që në të njëjtën kohë kjo ushtron ndikim edhe në formësimin e ardhmërisë së tyre. Krijimi i mjediseve të sigurt, humane dhe jo të dhunshme në shoqëri dhe shkolla është një kusht i domosdoshëm për të bërë maksimalizimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të arsimit dhe të edukimit në vendin tonë. Shpesh herë ne mendojmë për dhunën në shkollë, si një veprim i dhunshëm që ndodh në ambientet e shkollës. Dhuna mund të lidhet me institucionin arsimor nëse ajo ndodh brenda mjediseve të saj, tek një fëmijë i cili po shkon në shkollë ose është duke u kthyer nga shkolla. Megjithatë, duhet të pranojmë faktin se dhuna ndaj fëmijëve ndodh gjithandej dhe krijon pesimizëm për fundin që mund të sjellë. Pra, dhuna dhe dukuritë tjera negative në shkollë është problem kompleks dhe dukuri që ndodh si në shtetet e mëdha, të zhvilluara e me sistemet më të mira të qeverisjes, ashtu edhe në shtetet e vogla, si rasti në vendin tonë. Në Kosovën e pasluftës

fenomeni i dukurive negative në shkolla është në trend, shkaktarët e së cilës i gjejmë në gjendjen e vështirë ekonomike, në mungesën e sigurisë së mjaftueshme, në mungesën e perspektivës, në paragjykimet e vjetra etj. Një dukuri e tillë është dhuna ndaj fëmijëve në shkollë konsiston në qëndrime dhe sjellje që dëmtojnë fizikun ose njohësin shëndeti i fëmijëve dhe ndikon negativisht në zhvillimin e tyre (Greenwood, 2000). Sipas një hulumtimi të realizuar nga UNICEF-i me temë: “Hulumtim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës”, tregon qartë se dhuna në shkolla është mjaft e pranishme, shumica e nxënësve nuk ishin në gjendje të jepnin një përkufizim të qartë sa i përket dhunës. Ajo që vlen të theksohet, është se shumë nxënës kanë përjetuar dhunë në shkollë.

1.1 Prezantimi i problemit

“Arsimi në Kosovë ka për qëllim zhvillimin e dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike. Kjo u mundëson të rinjve të jenë qytetarë aktivë dhe të ndërgjegjshëm, të përballen në mënyrë konstruktive me dallimet dhe sfidat si dhe të respektojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve”. Përkundër këtij qëllimi, sot, jemi dëshmitarë të shumë dukurive negative që ndodhin ndërmjet nxënësve në shkollë, mos respektimit të drejtave të të tjerëve, dëshmitarë të një prej arsyeve e cila pengon realizimin e këtij qëllimi. Prandaj dukuritë negative si dhuna, pirja e duhanit, alkoolit, përdorimi i substancave dhe sjelljet devijante ndërmjet nxënësve në shkollë është njëra nga arsyet e përfshirjes - bashkëpunimit shkollë familje. Janë të shumta studimet të cilat tregojnë se “Nga bashkëpunimi shkollë familje është dëshmuar se përfitues janë nxënësit, shkolla përforcohet dhe ndihmohen mësuesit, përforcohen edhe familjet”. Kemi shumë studime të cilat fokusohen te bashkëpunimi mes shkollës dhe familjes përmes strategjive të ndryshme, por jo përmes përforcimit të kontakteve dhe bashkëpunimit shkollë-familje. Studimi i vetëm i cili është gjetur për faktorët që ndikojnë në bashkëpunim është ai i autorit (Carol, 2012), i cili i konsideron këta faktorë të rëndësishëm në bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve si: shkalla e përputhjes së kulturës dhe vlerave të shkollës dhe familjes, forca sociale në punë e familjes dhe shkollës, si i shohin rolet e tyre mësuesit e prindërit.

1.2. Objektivat e studimit

1. Evidentimi i nivelit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.
2. Eksplorimi i nivelit të bashkëpunimit të shkollës me familjen për përballimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.
3. Evidentimi i përvojave të mira në bashkëpunimin midis shkollës dhe familjes.

1.3 Rëndësia e studimit

Ky studim: “Roli i Pedagogut dhe organeve drejtuese të shkollës në parandalimin e dukurive negative në shkollë” është i rëndësishëm për disa arsye: 1. Institucioni shkollorë nuk mund ta kryejë detyrën e ngarkuar me ligj duke punuar vetëm. 2. Familja nuk i arrin dot qëllimet e saj duke mos u interesuar për jetën e fëmijëve në shkollë 3. Kompleksiteti që krijon dhuna në shkollë është herë pas here çështja më e komplikuar për shkollën dhe familjen.

KAPITULLI II

II. SHFLETIMI I LITERATURËS

2.1. Nocionet themelore, përkufizimi i nocioneve: dukuri negative, duhan, drogë, alkool dhe sjellje devijante në shkollë.

Roli i shkollës në parandalimin e dukurive negative, krahas zhvillimeve të mëdha në shoqëri, krahas asaj që jetën e kanë bërë më të lehtë, ato në të njëjtën kohë edhe kanë krijuar hapësira të ndryshme rrezikshmërie. Në këtë zhvillim shoqëror, fëmijët dhe të rinjtë janë ndër potencialet që më së shumti mund të jenë pre e rreziqeve të ndryshme. Gjithashtu edhe ndryshimet e vetë fëmijëve gjatë rritjes shpesh mund t'i gjejnë të dobët para situatave të ndryshme jetësore. Meqenëse ata pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në shkollë, shkolla mund të luajë rol shumë të madh në përgatitjen e tyre që të dinë t'iu ikin situatave jo të mira, por edhe në rast përpalljeje të reagojnë drejtë dhe të raportojnë me kohë dhe në vendin e saktë, (MASHT, 2014).

Me dukurinegative nënkuptojmë të gjitha ato sjellje apo veprime që i bëjnë individit në dëm të mirëqenies së tij dhe shoqërisë e ato janë: pirja e duhanit, alkoolit, substancave narkotike, shfaqjes së dhunës sjelljeve devijante etj. Përkufizimin e dhunës në literaturën e vëllimshme studiuesit e ndryshëm si ata ndërkombëtarë dhe ata shqiptarë si dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare japin mendime dhe përcaktime të ndryshme (Jonuzi, 2017).

Dhuna është dukuri e përgjithshme që shtrihet në të gjitha vendet e botës. Shtrirja dhe intensiteti i saj, janë arsye që shumë studiues, institucione, organizata vendore e ndërkombëtare të merren me studimin e këtij problemi dhe prezantimin e të dhënave për praninë dhe llojet e dhunës që ushtrohet mbi nxënës. Rezultatet e hulumtimeve të ndryshme pedagogjike, sociologjike dhe shëndetësore publike tregojnë se fëmijët dhe të rinjtë të cilët në moshë të re largohen apo e braktisin shkollën, konsumojnë alkool, narkotikë apo duhan, janë të dhunshëm ndaj vetëvetës dhe personave tjerë, të prirur për huliganizëm dhe paraqesin popullacionin i cili i ekspozohet rreziqeve të shumta si dhe pasojave për shëndetin e tyre, arritjet e tyre dhe zhvillim të përgjithshëm (Sokač, 2014 f. 117). Dhuna është një fenomen që mund të paraqitet në shumë forma duke filluar nga akte relativisht të vogla të tilla si sharje ose shtyrje, akte më të rënda të tilla si grushte, shkelma e deri te akte shumë të rënda të tilla si goditje me thikë, gjuajtje me armë dhe vrasje (Allen & Anderson, 2016). Përkufizimi më i zakonshëm i dhunës është se ajo është një formë ekstreme e agresionit që si synim kryesor ka shkaktimin e dëmit, lëndimin ose vdekjen (Anderson & Bushman, 2002, f.29). Në literaturën profesionale dhuna është definuar në shumë mënyra. Sipas (Olweus, 1993) "... një nxënës është abuzuar apo viktimizuar kur ai në mënyrë të përsëritur dhe të përhershme është ekspozuar ndaj veprimeve negative të një ose më shumë

nxënësve" (Olweus, 1998, f. 19). Organizata Botërore e Shëndetit e përkufizon dhunën si "përdorim i vullnetshëm i forcës a fuqisë fizike, si kërcënim ose e aplikuar, kundrejt një tjetri, person ose komunitet duke pasur me gjasë rezultate ose mundësi në dëmtime, vdekje, pasoja psikologjike, keqzhvillim, ose pamundësi", megjithëse grupi është i vetëdijshëm që përfshirja e "përdorimit të forcës" në përkufizimin e vet shtrihet përmbi kuptimit konvencional të fjalës.

Nocioni dhunë në fjalorin e psikologjisë nënkuptohet si një veprim i qëllimshëm i një individi për ta detyruar tjetrin me mjete të ndryshme qoftë fizike ose psikike, t'u nënshtrohet interesave apo dëshirave të dikujt tjetër (Nushi, 1987).

Në fjalorin e gjuhës shqipe dhuna ka domethënien e përdorimit të forcës, përdhunimit, keqtrajtimit, ashpërsisë etj. Dhuna në shkollë përfshin dhunën fizike, pra rrahjet e nxënësve mes vete që shkakton ndëshkime trupore, pastaj dhuna psikologjike, përfshirë abuzimin verbal, gjithashtu dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin dhe ngacmimin seksual; shumë forma të ngacmimit, përfshirë sulmin në internet dhe mbajtja e armëve në shkollë. Sipas (Olweus, 1999) "dhuna ose sjellja e dhunshme është sjellja agresive ku vepruesi përdor trupin e vet ose ndonjë objekt duke përfshirë edhe armë për të shkaktuar lëndim ose shqetësim relativisht serioz ndaj ndonjë personi tjetër".

Droga:- quhen të gjitha llojet e substancave që veprojnë në sistemin nervor qendror të njeriut, tjetërsojnë sjelljen e tij, si dhe krijojnë varësi fizike dhe psikike.

Ekzistojnë shumë lloje të drogave, ne do të cekim disa nga më të shpeshtat në vendin tonë dhe ato janë: kanabisi, heroina, kokaina, hashashi e të tjera.

Kanabisi prodhohet nga këрпи Indian (mariuana). Përdoruesit e tij kanë halucinacione, janë nervozë, qajnë. Edhe pse kanabisi nuk krijon varësi fizike mund të shkaktojë problem në kontrollin e përdorimit. Është shumë i rrezikshëm posaqërisht për përdoruesit e rinjë, për shkak të efekteve psikike dhe për arsye se shpie deri te ndërprerja e shkollimit dhe çrregullime psikike.

Heroina është substancë që prodhohet nga hashashi i opiumit. Shitet në formë të pluhurit me ngjyrë të bardhë, ose ngjyrë kafe ose si substancë e zezë e ngjitshme. Përdoruesit kanë rrjedhje të hundës, djersitje, ethe, dhembje të eshtrave, dhembje të ekstremiteteve dhe dëshirë të madhe për drogë.

Heroina zakonisht injektohet, thithet nga hunda ose tymoset si cigare. Heroina që injektohet është mënyra më e rrezikshme e përdorimit. Nga përdorimi i kësaj droge përdoruesit mund të fitojnë këto sëmundje: HIV, hepatitin B dhe C, si dhe sëmundje tjera infektive.

Kokaina është pluhur i bardhë që del nga gjethet e bimës “coca” të Amerikës Jugore, kjo klasifikohet në drogë simulantë që përkohësisht japin iluzionin e një energjie dhe fuqie të pakufishme dhe që pas mbarimit të efektit lënë përdoruesin në një gjendje depresive, të errët dhe tenduese për të marrë doze tjetër. Kreku është forma e tymosjes së kokainës të ndryshuar kimikisht. Si kokaina edhe kreku shpien në varësi të shkallës së lartë.

Duhani:- është materie e cila përmbanë më shumë se 4000 substanca helmuese si nikotinë, monoksid karboni, metale të rënda. Nikotina është drogë e fuqishme që shkaktonë varshmëri, e cila gjendet në duhan. Përdorimi i duhanit mund të shkaktojë kancerin, sëmundjet e zemrës, çrregullime të gjumit dhe të humorit.

Duhani nuk është i dëmshëm vetëm për shëndetin e personave që e konsumojnë por edhe për gjepin e tyre. Duhani është i dëmshëm posaqërisht për gratë shtatzëna, personat me sëmundje të ndryshme kronike, fëmijët dhe të rinjët, sportistët nuk guxojnë ta konsumojnë duhanin.

Pirja e duhanit nuk i dëmton vetëm ata të cilët e konsumojnë por edhe personat të cilët rrinë në ambiente ku konsumohet duhani, ndryshe këta persona mund të quhen duhan pirës pasiv.

Alkooli:- konsumimi i alkoolit shkakton pasoja për shëndetin, probleme sociale, ose të dyjat së bashku.

Varësia nga alkooli është një sëmundje e karakterizuar nga nevoja anormale për alkool që qon në prishje të kontrollit mbi të pirit. Konsumimi i alkoolit shkatërron mëllçinë, lukthin dhe miliona qeliza trurorë. Veprimet e të dehurit janë të paparashikueshme, personat që konsumojnë alkool shkatërrojnë vetën dhe rrethin e tyre.

Personat që konsumojnë alkool e ndryshojnë sjelljen dhe mund të bëhen agresiv dhe ka gjasa më të mëdha që të fillojnë grindje, po ashtu ndikon edhe në trurin tonë ashtu që të harrojmë se çfarë kemi bërë.

Shitja e alkoolit për personat nën moshën 18 vjeç është jo ligjore, po ashtu edhe vozitja në gjendje të dehur është jo ligjore dhe e sanksionuar me ligj përfshirë edhe dënimin e mundur me burg(MASHT, 2014).

Sjelljet deviante:- me sjellje deviante kuptojmë, çdo mënyrë, sjellje të një individi apo grupi shoqëror që dallon në mënyrë të dukshme nga normat, zakonet dhe ligjet që sundojnë në një shoqëri të caktuar. Në sociologji, devijimi përshkruan një veprim ose sjellje që shkel normat shoqërore, duke përfshirë një rregull të miratuar formalisht (krimin), si dhe shkeljet informale të normave shoqërore. Megjithëse devijimi mund të ketë konotacion negativ, shkelja e normave shoqërore nuk është gjithmonë një veprim negativ, devijimi pozitiv ekziston në disa situata. Megjithëse shkelet një normë, një sjellje ende mund të klasifikohet si pozitive ose e pranueshme.

Normat shoqërore ndryshojnë nga kultura në kulturë. P.sh, një veprim deviant mund të kryhet në një shoqëri, por mund të jetë normale për një shoqëri tjetër. Devijimi është relativ në vendin ku është kryer ose në kohën kur veprimi u krye. Devianca ka ekzistuar dhe ekziston në të gjitha shoqëritë që mbështetet mbi norma ose ligje. Në shoqëri të tilla ka vetëm tri mundësi se si një individ mund të veprojë në raport me këto norma:

1. T'i respektojë dhe të veprojë në përputhje me to.
2. T'i respektojë dhe t'i thyejë ato,
3. T'i respektojë disa norma dhe të veprojë në kundërshtim me disa të tjera. Natyra e sjelljeve deviante ndryshon shumë në varësi të shkallës dhe të rrezikshmërisë shoqërore që ato paraqesin. Sjellja deviante në klasë konsiderohet si një manifestim i akteve(sjelljeve) nga ana e nxënësit, që nuk janë të legjitimuara nga mësuesit në kontekstin e rregullave të praktikës pedagogjike dhe që shpien për pasojë, në prishjen e procesit normal të mësimdhënies dhe të nxënies. Në këtë kuptim çdo akt i nxënësit që është brenda rregullave të vendosura në klasë nga mësuesi, shihet si normal, ndërsa çdo akt që është jashtë këtyre rregullave shihet si deviant. Ato si të tilla mund të përkufizohen: alkoolizmi, zhveshja, vjedhjet, gënjeshtat, fyerje etiketuese, ngacmimin e njerëzve, lënien e mësimit, zhurma në klasë etj(Berishaj,A. Berisha, I. Hasani, I. Prishtinë 2015)

2.2. Dukuritë negative që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve

Përdorimi i substancave narkotike Republika e Kosovës është e njohur si një ndër vendet me popullatën më të re në Evropë. Edhe pse nuk kemi të dhëna të sakta mbi numrin e fëmijëve dhe personave të moshës së re, mendohet se Kosova ka popullatën më të re në Evropë, dhe sipas vlerësimeve të programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Gjysma e popullatës është nën moshën 25 vjeçare, kurse 21% e banorëve të saj janë të moshës 16 dhe 25 vjeç. Po ashtu shkalla e papunësisë në Kosovë është e lartë, posaçërisht te të rinjtë. Duhet llogaritur po ashtu se shoqëria jonë është duke e kaluar fazën më të vështirë të këtij tranzicioni, dhe kjo ka rezultuar me shfaqjen dhe përhapjen e dukurive negative. Kjo ka bërë që edhe Kosova, e cila në vitet 68 radhitej si një ndër vendet me rini të shëndoshë, në fillim të viteve 1999 me ndryshimet tranzicionale të radhitet në mesin e vendeve europiane, ku dukuritë negative janë shfaqur dhe janë evidente në shoqërinë kosovare MASHT-i në kuadër të programeve shumësektoriale, siç është programi Shkollat promovuese të shëndetit, synon ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të fëmijëve në shkolla. Objektivi i shkollave promovuese të shëndetit është që të përkrahen shkollat dhe të zhvillojë politika e programe efektive, që do të përforcojnë dhe do t'i bëjnë të shëndetshme dhe të qëndrueshme mjediset në të cilat zbatohen politikat.

2.3. Shërbimi pedagogjik

Në vitin 2011 u krijua ligji mbi arsimin parauniversitar në Kosovë ku shërbimi profesional njihej si shërbim pedagogjik dhe në kuadër të tij përfshihej pedagogu, psikologu, këshilltari i shkollës që kishin detyrë përmirësimin dhe avancimin e punës në shkollë (Beqiri, 2014). Pedagogu i shkollës bënë pjesë në stafin profesional. Me Ligjin për Arsimin Parauniversitar, pedagogët përfshihen në personelin profesional jomësimdhënës. “Përsonat e kualifikuar sipas standardeve të specifikuara në një akt nënligjor mund të zgjidhen nga komuna në institucionet arsimore për të ofruar shërbime profesionale, përfshirë: kujdesin mjekësor, mbështetjen pedagogjike-psikologjike, si dhe punë këshilluese dhe sociale”. (Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 37, pika 1, faqe 25). Detyrat e punës së pedagogut të shkollës orientohen në organizimin e punës drejt realizimit të detyrave të planifikuara në Planin zhvillimor të shkollës dhe të Drejtorisë Komunale të Arsimit, në harmoni me dokumentet pedagogjike të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe konform planifikimit dhe realizimit të punës së gjithmbarshme në shkollë. Detyrat e punës së pedagogut të shkollës: Sipas udhëzimit administrativ nr 26/2013 shërbimi profesional zgjidhet nga komuna në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MASHT-i, ku përfshihej mjeku, pedagogu, psikologu, këshilluesi dhe punëtori social. Ky udhëzim lë në dorën e komunës përzgjedhjen e shërbimit profesional në bazë të disa kriterëve:

- Një shërbyes profesional, punësohet në institucionin edukativo-arsimor nëse institucioni ka mbi 1000 nxënës/fëmijë.
- Shërbyes profesional, mund të punësohen edhe në disa institucione edukativo-arsimore, të cilat bashkë e arrijnë numrin mbi 1000 nxënës/fëmijë.
- Shërbyesit profesional, mund të punojnë si mësimdhënës vetëm nëse posedojnë licencë për mësimdhënës’.

Ndërsa MASHT ka vetëm këto kompetenca për shërbimin profesional:-

- Të përcaktojë nivelin e kualifikimit profesional sipas normativit.
- Të licencojë shërbyesit profesional, pedagogët, psikologët dhe sociologët.
- Këshilli shtetëror për licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM), akrediton programet për zhvillim profesional për kategoritë e cekura më lartë. (Masht, UA26, 2013).

Pedagogu i shkollës punon së bashku me psikologun e shkollës në të gjitha çështjet e përbashkëta profesionale të përcaktuara nga udhëzimi administrativ për shërbimin profesional.

Andaj, pedagogu i shkollës ka për detyrë të koordinojë aktivitetet mësimore të realizuara nga mësimdhënësi, të ndihmojë në krijimin e planprogrameve duke vlerësuar nevojat për ndryshim apo plotësim, mangësitë e ndryshme, përmbajtjet mësimore dhe të kontrollojë se a janë të bazuara në interesat dhe nevojat e zhvillimit të personalitetit të nxënësit (Hoti, dhe bashkëpunëtorët, 2016b). Shumica e pedagogëve punojnë në fushën e edukimit dhe kujdesit të fëmijërisë së hershme. Në këtë kontekst ato janë të krahasueshme me "Parashkollën mësues" në vende të tjera. Në sektorin e kujdesit jashtë shkollës ata mund të krahasohen me "punonjësit e lojës" ose "instruktorët e re kreacionit", dhe në shërbime të tjera ata janë më shumë si "Punëtorët social" ose "Edukatorët" (Hoti, dhe bashkëpunëtorët, 2016b).

2.4 Detyrat e pedagogut të shkollës

Pedagogu i shkollës kontrollon rrjedhën e orës mësimore, qasjen metodologjike, përcjell vlerësimin e nxënësve, kohën dhe mënyrën se si ata vlerësohen, si dhe përgatit raport për orët e hospituara duke dhënë rekomandime, këshilla dhe sugjerime për arritjen e rezultateve të dëshiruara qoftë për njësi mësimore apo lëndë të caktuara mësimore (Hoti, dhe bashkëpunëtorët, 2016b).

Shërbimi profesional, gjegjësisht pedagogu i shkollës ka para vetes një mori detyrash që e karakterizojnë punën e tij në shkollë. Në fakt, këto detyra janë të lidhura plotësisht me shkollën si institucion edukativo-arsimor, me gjithë faktorët që ndërveprojnë në realizimin dhe zhvillimin e procesit edukativ dhe arsimor. Realizimi i këtyre detyrave nga ana e pedagogut të shkollës duhet të bëhet në përputhshmëri të plotë me ligjet e përcaktuara nga MASHT-i dhe dokumentet e tjera pedagogjike relevante. Puna edukativo- arsimore padyshim që kërkon planifikim në rend të parë dhe organizim të mire. Pedagogu i shkollës ndërvepron me mësimdhënësit në realizimin e programimit dhe zhvillimit të suksesshëm të punës edukative dhe arsimore. Zhvillimi i suksesshëm i punës edukativo-arsimore shpeshherë mund të arrihet vetëm tek disa mësimdhënës e jo tek tërë stafi, andaj shkolla duhet të ketë një plan zhvillimor, hartimi dhe mbështetja e të cilit bëhet nga ana e pedagogut. Krijimi i një plani zhvillimor mund të themi që paraqet një listë me hapa, në baza të të cilave do realizohet procesi mësimor në shkollë. Puna edukativo-arsimore në anën tjetër përfshin planprogramet e realizuara nga mësimdhënësit, që duhet të jenë në përputhshmëri me kërkesat specifike si: të krijohen planprograme që ndikojnë në përgatitje shkencore me dituri të reja dhe përgatitja e brezit për jetë. Krijuesit e planprogrameve, pra mësimdhënësit duhet të kenë përgatitje edhe në aspektin pedagogjik, psikologjik dhe didaktik.

Andaj, pedagogu i shkollës ka për detyrë të koordinojë aktivitetet mësimore të realizuara nga mësimdhënësi, të ndihmojë në krijimin e planprogrameve duke vlerësuar nevojat për ndryshim apo plotësim, mangësitë e ndryshme, përmbajtjet mësimore dhe të kontrollojë se a janë të bazuara në interesat dhe nevojat e zhvillimit të personalitetit të nxënësit (Hoti, dhe bashkëpunëtorët, 2016a). Të gjitha këto dhe shumë cilësi të tjera pedagogu i shkollës i vëren gjatë monitorimit dhe vlerësimit që e bënë gjatë vizitave nëpër orë mësimore. Monitorimin dhe vlerësimin e bënë pedagogun e shkollës përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, andaj gjithmonë duhet tentuar në zhvillimin e një komunikimi efektiv me mësimdhënësit, në një vlerësim të drejtë, në ofrimin e ndihmës së vazhdueshme në mënyrë që të rritet cilësia e mësimdhënies dhe të nxënësve. Në anën tjetër, shkolla si institucion, mësimdhënësi dhe punëtorët e shërbimit profesional si faktor edukativ, çdo herë duhet të jenë ‘‘të përditësuar’’ me të reja më të fundit në çdo fushë zhvillimi, në mënyrë që të realizojnë punë edukative dhe arsimore sa më cilësore konform nevojave të vet nxënësve dhe ndryshimeve shoqërore, ekonomike, sociale etj. Pedagogu në këtë rast ka detyrë që të hulumtojë rreth nevojave mësimore, të sjellë praktika dhe projekte të reja duke bërë hartimin e tyre gjithmonë në përputhshmëri me këto nevoja. Bashkëpunimi efikas mes drejtorit të shkollës dhe pedagogut do realizonte dhe plotësonte më së miri këto nevoja mësimore, praktika e projekte duke tentuar gjithmonë që të jenë në pajtueshmëri me planin zhvillimor të shkollës. Të njëjtën kohë bashkëpunimi me prindërit, nxënësve, komunitetin, është më se i domosdoshëm për arritjen e një mbarëvajtje të përgjithshme të punës në shkollë. Preferohet që pedagogu i shkollës të marrë pjesë në mbledhjet e këshillave të prindërve, nxënësve që të njihet për së afërmi më çfardo kërkesë apo nevojë të tyre dhe në të njëjtën kohë të prezantojë mënyrat, teknikat dhe strategjitë më të mira për arritjen e suksesit të punës edukativo-arsimore, në aspektin e dhënies dhe pranimit të çdo sugjerimi e këshille, e në përputhje me këto nevoja të jenë të përgaditur për çdo lloj praktike apo sfide që mund të shfaqet në shkollë. (Hoti, dhe bashkëpunëtorët, 2016b).

2.5 Roli i pedagogut të shkollës

Roli i pedagogut ka pësuar ndryshime relativisht të mëdha si pasojë e ndryshimeve që kanë ndodhur ndër vite në sistemin arsimor në Kosovë. Detyrat, përgjegjësitë dhe pritshmëritë për punën e pedagogut janë rritur tejet shumë, së pari, rreth njohjes së këtyre ndryshimeve, njohjes së implementimit të Kurrikulës së Kosovës, e pastaj vështirësitë me të cilat përballen mësimdhënësit dhe ndihma që duhet ofruar atyre. Këto ndryshime në përgjithësi kanë ndikuar në shfaqjen e roleve të shumfishta të pedagogut të shkollës. Që këto ndryshime të trajtohen me kujdes dhe me profesionalizëm kërkohet planifikim, programim dhe organizim i punës

edukativo-arsimore. Çdo planifikim dhe organizim, në këtë rast, planifikimi dhe organizimi i punës edukativo-arsimore kërkon vlerësim që të kuptohet se a realizohet procesi edukativo-arsimor në mënyrën e duhur (Hoti, dhe bashkëpunëtorët, 2016a). Por cili është roli i pedagogut në këtë rast dhe cila është ndihma që ofron ai? Vlerësimi i punës edukativo-arsimore bëhet nga ana e pedagogut i cili mbështet në dokumentacionet e shkollës. Shkolla si institucion ka dy lloj dokumentacionesh: dokumentacionin administrativ dhe pedagogjik të jashtëm i cili përfshin të gjitha dokumentet zyrtare të institucioneve që udhëheqin procesin e punës në shkollë dhe dokumentacionin administrativ dhe pedagogjik të brendshëm i cili përfshin në vete të gjitha dokumentet e përgaditura nga shkolla dhe të cilat janë pjesë e punës së saj. Njohja e këtyre dokumentacioneve nga ana e pedagogut bënë të mundshme që ai të njohë kërkesat nga institucionet e larta, gjeëgësisht kërkesat dhe pritshmëritë në dokumentet e institucioneve të jashtme për realizimin e procesit edukativo-arsimor. Pedagogu shikon dhe vlerëson këto dokumente në përputhshmëri me dokumentet pedagogjike të brendshme të shkollës, ku implementimin e kërkesave të praktikave të reja zhvillimore e bënë përmes bashkëpunimit me udhëheqësit e shkollës dhe gjithë akterëve të tjerë. Çdo risi apo projekt ose praktikë e re shfaqë ndryshime në ecurinë e procesit mësimor duke shfaqur në të njëjtën kohë pritshmëri të reja tek mësimdhënësit. Pedagogu i shkollës bashkëpunon me udhëheqësit e shkollës në realizimin e projekteve të reja mësimore dhe në mbajtjen e trajnimeve me bazë në shkollë të mësimdhënësve për plotësimin e çdo nevoje rreth implementimit të këtyre projekteve. Dokumentacioni administrativ dhe pedagogjik i brendshëm përpos dokumenteve rreth ecurisë mësimore dhe punës edukativo-arsimore të mësimdhënësve ka dhe dokumentet për punës personale që kryen pedagogu i shkollës. Pedagogu i shkollës së pari duhet të ketë një plan për menaxhimin e dokumentacionit pedagogjik shkollor, duhet të përpunojë një plan vjetor për punën e tij dhe planin e veprimit sipas këtij plani vjetor, të ketë një kalendar të takimeve dhe aktiviteteve kryesore, ditarë për mentorimin e procesve mësimore, evidenca dhe raporte për punën mësimore gjatë vëzhgimeve në orë mësimore, pastaj të ketë edhe një evidencë për aktivitetet e zhvilluara si dhe një plan të veçantë për punën më nxënësit dhe me mësimdhënësit varësisht nevojave të tyre. Realizimi i suksesshëm i punës së pedagogut të shkollës arrihet atëherë kur pedagogu ka njohje në aspektin teorik dhe praktikë qoftë për procesin mësimor, për metodologjinë mësimore, për pengesat që mund të shfaqen gjatë procesit mësimor. Njohja e tyre mundëson që mësimdhënësit të ndjehen siguri tek pedagogu i shkollës sepse vërtet gjërat janë shumë më ndryshe kur thuhet ne teori dhe kur aplikohen në praktikë. Kur pedagogu ka këtë kompetencë dhe fushë të arritshme atëherë bëhet një analizues dhe vlerësues suksesiv i punës mësimore. Pedagogu i shkollës vëzhgon dhe hospiton orën mësimore, vlerëson dhe bashkëpunon në krijimin e planeve dhe

programeve mësimore së bashku me mësimdhënësit, ndihmon dhe këshillon në nevojat dhe sfidat e mësimdhënësve dhe përkrah mësimdhënësit në vlerësimin e nxënësve. Pedagogu i shkollës vlerëson performancën e mësimdhënësve duke krijuar raporte për vlerësimin e tyre si dhe duke kërkuar vetvlerësim nga ana e mësimdhënësve për punën e tyre (Hoti, dhe bashkëpunëtorët, 2016a). Kjo bënë që vetë mësimdhënësit të shohin cilat janë fushat e suksesshme të tyre dhe cilat janë fushat që kanë nevojë për përmirësime. Kohëve të fundit, puna mësimore e mësimdhënësve dhe vlerësimi i punës mësimore nga ana e pedagogut të shkollës mbështet në Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar (2011/ e rishikuar me 2016). Kjo kornizë ‘përcakton një qasje të bazuar në kompetenca, respektivisht qasje të orientuara kah rezultatet e pritura që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit’ Roli i mësimdhënësve tashmë nuk ishte vetëm të ofronte dije, por të zhvillonte kompetencat kryesore, të zhvillonte shkathtësi sociale, shkathtësi të planifikimit, vlerësimin, monitorimit, të zhvillonte aftësi për organizimin e proceseve efektive mësimore duke pasur parasysh dallimet e interesave, afiniteteve dhe mundësive të nxënësve. Roli i shërbimit profesional, gjegjësisht roli i pedagogut të shkollës u përcaktua si mbikëqyrës i performancës së kuadrit mësimor, si planifikues dhe bashkëpunues me mësimdhënësit për procesin mësimor, inicues dhe mentorues, si dhe përkrahës i organeve udhëheqëse të shkollës për zbatimin e kurrikulës Masht& Instituti Pedagogjik i Kosovës, (2016). Gjatë realizimit të punës së tij pedagogu i shkollës mund të hasë edhe në shumë pengesa, që shpeshherë këto pengesa lidhen me personalitetin e mësimdhënësit. Disa mësimdhënës shpeshherë shfaqin sjellje të tipit autoritar duke mos ofruar hapësirë për bashkëpunim me të dhe mos pranuar asnjë kritikë apo këshillë nga të tjerët, as nga pedagogu, ose mund të shfaqin sjellje indiferente duke mos u shqetësuar për rrjedhjen e orës, interesat dhe nevojat e nxënësve apo duke u shqetësuar vetëm për punën e tij dhe jo për nxënësit ose e kundërta. Këto personalitete të mësimdhënësve ndikojnë shumë në cilësinë e bashkëpunimit me pedagog. Në këtë rast pedagogu i shkollës gjen përshtatje për personalitetin e mësimdhënësit duke përdorur takt pedagogjik dhe duke ofruar një klimë pozitive të bashkëpunimit, duke tentuar që të mbështes dhe zhvillojë anët pozitive të mësimdhënësit dhe të ndikojë që mësimdhënësi të kuptojë fushat ku ka nevojë për ndryshime. Kjo mund të arrihet kur pedagogu ofron komunikim empatik që nënkupton bashkëndjesinë me gjëndjen e mësimdhënësit duke krijuar bindjen tek mësimdhënësi që tek ai mund të drejtohet për çdo nevojë dhe problem që ka. Pedagogu i shkollës zhvillon punën e tij me profesionalizëm dhe qasje pedagogjike ndaj punës së mësimdhënësve dhe punës së shkollës. Kështu një nga rolet e pedagogut të shkollës është edhe të qenurit këshillues pedagogjik. Këshillimi pedagogjik ka për qëllim ofrimin e ndihmës profesionale nga ana e ekspertëve të specializuar si (pedagogët,

psikologët, punëtorët socialë, mjekët) që kanë përgaditje profesionale në njohjen e qëllimeve të edukatës, subjekteve që edukohen dhe mënyrën se si duhet realizuar puna instruktive pedagogjike. Puna e pedagogut në këtë rast kërkon përgaditje të shumëanshme, pikë së pari, në njohjen dhe rrjedhjen e procesit të këshillimit, njohjen e metodave dhe teknikave se si duhet realizuar këshillimin pedagogjik qoftë me nxënës, mësimsdhënës, familjen, komunitetin apo faktorët e tjerë edukativ. Këshillimi pedagogjik ofron qasje dhe programe të shumëllojshme, që nga ana e pedagogut të shkollës duhet bërë përzgjedhja e duhur e tyre konform nevojave dhe kushteve adekuate. Këshillimi pedagogjik dhe profesional i pedagogut të shkollës zhvillohet me nxënësin, mësimsdhënësin, familjen, me komunitetin dhe me faktorët e tjerë edukativ. Gjatë këshillimit pedagogjik me nxënësin, pedagogu arrin të njoh karakterin e nxënësit, nevojat dhe interesat e tij dhe në bazë të tyre realizon dhe planin e këshillimit pedagogjik. Duke pasur parasysh që çdo problem dhe vështirësi ndikon në procesin e të nxënësve, pedagogu përmes rolit këshillues ofron ndihmë dhe përkrahje për nxënësit gjersa të vërej ndryshime. Realizimi i procesit të këshillimit shpesh mund të përcillet me probleme kur nxënësit nuk gjejnë vetën në këshillimin e ofruar qoftë nga klima e ofruar apo nga komunikimi që zhvillon pedagogu. Çka kërkohet nga pedagogu në këtë rast, është që të ofrojë një klimë pozitive dhe të rehatshme për nxënësin, të jetë komunikues efektiv dhe i gatshëm edhe të dëgjojë mendimet dhe reagimet e nxënësit. Këshillimi preferohet të zgjasë derisa pedagogu të vërej përmirësime tek nxënësi. Përdorja e këshillimit realizohet me nxënësin padyshim që edhe familja bëhet pjesë e këshillimit në mënyrë direkte apo indirekte. Njohja e strukturës familjare, njohja e gjendjes ekonomike, sociale, të familjes, ndikon që pedagogu të njeh mënyrën e qasjes ndaj nxënësit dhe ndaj familjes si dhe shpeshherë gjetjen e shkakut të çdo vështirësie me të cilën përballlet nxënësi (Krasniqi & Deva-Zuna, 2012). Këshillimi pedagogjik ofron një ndihmesë zinxhirore mes shkollës-nxënësit dhe familjes, duke pasur si qëllim përfundimin e suksesshëm për subjektin, gjegjësisht nxënësin. Kështu, pedagogu i shkollës përfshihet si ndihmues në këtë trekëndësh duke krijuar një klimë pozitive brenda këtyre faktorëve, e përfshirë nga bashkëpunimi dhe respekti reciprok. Pastaj, merren me studime, analiza dhe vlerësime, që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e planprogramve mësimore, të formave të ndryshme të punës edukative ; bëjnë kategorizimin e fëmijëve sipas aftësive psikofizike për vijimin e shkollës, përkatësisht për orientimin profesional të nxënësve në shkollën e mesme; planifikojnë, organizojnë dhe vlerësojnë kontaktet individuale, në grup dhe kontaktet kolektive me prindër; ndihmojnë arsimtarët të organizojnë drejtë punën arsimore e edukative, të mos i ngarkojnë nxënësit me faktografi të tepruar, me enciklopedizëm dhe historicizëm. (Brada, 2005). Detyrat e mësuesve janë më të ndërlikuara se kurrë. Ata duhet t'i përgjigjen, nevojave të një popullate të

shumëllojshme dhe të ndryshueshme nxënësish, një teknologjie të vendit të punës që ndryshon me shpejtësi dhe kërkesave për një punë të përkryer nga të gjithë segmentet e shoqërisë. Megjithatë nga ana tjetër, ne kemi një sistem arsimor që në thelb është konservator. Mënyra se si përgaditen mësuesit, mënyra se si janë organizuar shkollat, mënyra se si funksionon hierarkia arsimore, dhe mënyra se si trajtohet arsimi nga politikanët vendimmarrës, rezultojnë në një sistem që ka më shumë të ngjarë të ruaj status-kuonë se sa të sjellë ndryshimin. (Fullan, 2010). Pedagogu i shkollës përveç formave dhe aktiviteteve ai përgadit edhe ligjerata për nxënës dhe arsimtar, si dhe rritë efikasitetin e trekëndësisht shkollë-familje-nxënës. Ai është në gjendje të shohë problemet dhe të ndër marrë masat e duhura me kohë. (Nuredini, 1999). Një ashtu ndihmon në përpilimin e planit operativ vjetor dhe mujor; merr pjesë në punën rrethregjistrimit të nxënësve në kalsë të parë si dhe ndihmon në organizimin dhe mbajtjen e mësimit plotësues, vazhdues dhe shtues. (Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2014). Ky vend pret të i dalin zot. Ata që e shkatërrojnë janë shumë ata që e ndërtojnë janë pak. Kështu që ata që punojnë, duhet të punojnë natë e ditë për të riparuar dëmet që u janë bërë deri tani sistemit tonë arsimor, kjo punë kërkon sakrificë e nuk kërkon që të presësh shpërblim nga të tjerët. (Ertugrul, 2000). Pedagogu i shkollës është ekspert i cili me punën e tij i kontribon lehtësimit të problemeve të ndryshme që shfaqen në shkollë si tek nxënësit, mësuesit, prindërit apo të gjithë akterët tjerë shkollor si dhe kontribon në ngritjen e cilësisë së veprimtarisë edukative-arsimore. (Udhëzimi Administrativ MASHT nr.34/2014).

2.6 Mungesa e stafit pedagogjik në shkolla dhe sfidat në sistemin e arsimit parauniversitar

Për mungesën e stafit pedagogjik në shkolla dhe mungesën e tyre për këtë janë shprehur shumë pedagogë, drejtues shkollash, arsimtarë, prindër etj. Sot shkolla jonë po ballafaqohet me probleme të shumta. Dhe këto probleme dita më ditë po grumbullohen, gjë që natyrisht po kërkojnë një qasje të ngutshme e tejet serioze nga të gjithë faktorët shoqërorë. Disa nga këto probleme, siç janë: konfliktet e shpeshta nxënës – nxënës, arsimtar – nxënës, arsimtar – arsimtar, me mungesa të shumta, me ikje nga orët mësimore, me delikuencë, me sjellje asociale, me braktisjen e shkollës nga nxënësit, me thyerje të inventarit shkollor, rënia e disiplinës, ngarkesat psikike dhe sëmundjet e ndryshme, bashkëshortësitë e hershme, shkurorëzimet e shpeshta, konfliktet në bashkëshortësi dhe familje, vetëvrasjet, mungesa e sjelljeve kulturore etj. që na sinjalizojnë për përmasa alarmuese, pastaj me dhunën, abuzimet e ndryshme, me konsumimin e lëndëve narkotike, me trafikimin e qenieve njerëzore etj. Prandaj Dega e Pedagogjisë konsideron se puna e pedagogut të shkollës, sidomos në arsimin tonë, është domosdoshmëri, ngase:

- Ai është eksperti didaktik i shkollës dhe padyshim do të kontribuonte në të mirë të mësimin dhe arsimit në përgjithësi;
 - Shërbimi pedagogjik – psikologjik në shkollë, është një ndër organizatorët kryesorë të punës edukativo-arsimore;
 - Është një këshilltar permanent i arsimtarëve;
 - Është urë lidhëse ndërmjet partneritetit shkollë – familje – komunitet, është në të vërtetë lokomotiva e vërtetë e punës në shkollë;
 - I ndihmon dhe i orienton nxënësit për profesionin;
- Harton planin individual të punës në përputhje me specifikat e shkollës në të cilën punon;
 - Bashkërendon punët me drejtorin e shkollës në funksion të realizimit të rezultateve të pritura konform planit zhvillimor të shkollës;
 - Merr pjesë në mbledhjet me prindër, këshill të arsimtarëve, aktiveve profesionale duke dhënë këshilla dhe sugjerime në funksion të mbarëvajtjes së përgjithshme të punës së shkollës
 - Mban takime individuale me prindër, arsimtar, nxënës dhe faktor tjerë që kanë ndikim direkt ose indirekt në procesin e punës edukative dhe arsimore;
 - Përcjell vlerësimin e nxënësve, kohën e vlerësimit dhe mënyrën e tij si dhe vijueshmërinë e nxënësve në shkollë;
 - Zhvillon vizita nëpër orë mësimore dhe përgatitjen e raporteve për orët e hospituara duke dhënë rekomandime, këshilla dhe sugjerime në funksion të realizimit të rezultateve të pritura konform njësisë mësimore dhe lëndës së caktuar mësimore;
 - Punon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies;
 - Mban përgjegjësinë kryesore në zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
 - Bashkëpunon në hartimin e planit të punës për mësimdhënësit e lëndëve dhe klasave të ndryshme dhe raporton për aktivitetet e zhvilluara;
 - Zhvillon dhe përkrah sistemin gjithëpërfshirës që siguron qasje të barabartë në arsim për të gjithë pa dallim;
 - Kryen punë tjera të caktuara nga udhëheqësi konform detyrave të punës.

• Pedagogu duhet të ndikojë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies. Është vështirë të mendohet se të gjithë mësimdhënësit mund të përgatiten njësoj në mënyrë të pavarur për punë mësimore në shkollë, të cilët do të mund të planifikonin dhe të organizonin, e aq më tepër të avancojnë veprimtarinë mësimore pa pasur mbështetje nga shërbimi profesional pedagogjik. Dihet se mësimdhënia dhe nxënia janë një veprimtari e veçantë profesionale dhe shumë dinamike, ku nuk mund të jenë të mjaftueshme njohuritë e ngushta profesionale pa njohuritë e tjera shtesë nga pedagogjia, psikologjia, teoria e mësimit, metodika etj. Prandaj institucionet tona duhet ta kuptojnë se shërbimet profesionale pedagogjike e psikologjike janë të vlefshme dhe të nevojshme për shkollën tonë sot sikurse mjeku për spitalin, inxhinieri për fabrikën, mentori për hulumtuesin, agronomi për bujqësinë etj.

2.7. Detyrat e tjera dhe objektivat e shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë

Detyrat e shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkollës janë të shumta dhe të ndryshme. Këtu do të listojmë vetëm disa nga ato më të domosdoshmet.

1. Pedagogu ndihmon shumë për krijimin e ambientit më të përshtatshëm për mësim dhe adaptimin e nxënësve brenda tij.
2. Pedagogu ka përgjegjësi shumë të madhe për mirëvajtjen e punës mësimore në shkollë, nga menaxhimi i klasës deri te realizimi i planit dhe i programit mësimor.
3. Ndihmon zhvillimin profesional të stafit të shkollës.
4. Ndihmon ngritjen e cilësisë dhe të efikasitetit të mësimit.
5. Mat dhe vlerëson produktivitetin e punës individuale të mësuesve në shkollë.
6. Pedagogu është nxitës dhe bartës i risive dhe i ndryshimeve pozitive në mësim dhe në shkollë.
7. Pedagogu ndihmon krijimin e raporteve më të mira në shkollë dhe jashtë saj, si: nxënës-mësues, nxënës-nxënës, mësues-mësues, mësues-prind, shkollë-komunitet etj.
8. Pedagogu ndihmon për parandalimin e situatave të konfliktit në shkollë dhe për zgjidhjen e tyre.
9. Ai është parandalues i sjelljeve devijuese të nxënësve, braktisjes së shkollës, rrugaçërisë, narkomanisë, prostitucionit etj.
10. Pedagogu është edhe hulumtues i drejtpërdrejtë në shkollë.

2.8 Disa detyra specifike të pedagogut dhe të psikologut në shkollë

Detyrat e pedagogut nënkuptojnë problemet e mësimin dhe të edukimit, veçmas të orientuara në intensifikimin, racionalizimin, demokratizimin dhe modernizimin e edukimit dhe të mësimin në shkollë. Në lidhje me këtë, pedagogu, posaçërisht duhet t'i kryejë këto detyra në shkollë:

- Ndjek dhe hulumton problemet e edukimit dhe të mësimdhënies e të nxënies.
- Merr pjesë në planifikim dhe ndjek realizimin e planit dhe të programit të punës edukativo-arsimore, kontakton me mësimdhënësit, kujdestarët e klasave, me këshillin e mësimdhënësve, me aktivitet tjera profesionale.
- Bashkëpunon me komisionin, i cili vlerëson përgatitjen/ pjekurinë/ e fëmijëve për regjistrim në klasë të parë të shkollës fillore.
- Planifikon dhe sugjeron mënyrat e formimit të paraleleve dhe të klasave.
- Ndjek dhe i studion rezultatet e punës edukativo-mësimore.
- Konstaton ngarkesën e nxënësve në klasë me kujdestarin dhe mësimdhënësit tjerë.
- Hulumton dhe i analizon shkaqet e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve dhe propozon masa për evitimin e tyre.
- Ndhmon mësimdhënësit për evitimin e shkaqeve të prapambetjes së nxënësve në mësim.
- Bashkëpunon me mësimdhënësit në përpilimin e instrumenteve hulumtuese për përcjelljen dhe vlerësimin e mësimin.
- Organizon punën në orientimin profesional të nxënësve dhe bashkëpunon me shërbimin për orientim profesional.
- Merr pjesë në organizimin e mësimin të aktiviteteve të lira.
- Ndhmon mësimdhënësit në përsosjen profesionale dhe pedagogjike.
- Bashkëpunon me kujdestarët e klasave dhe u ndihmon në punën e tyre pedagogjike me klasat.
- Planifikon dhe organizon bashkëpunimin e shkollës me komunitetin.
- Ndhmon në planifikimin e aktiviteteve të forumeve të nxënësve.
- Ndhmon në përpilimin e planit mujor dhe vjetor të arsimtarëve.
- Ndjek, këshillon dhe mëson arsimtarët për vlerësimin e drejtë të nxënësve;
- Ndjek disiplinën, sukseset dhe realizimin e planit dhe programit etj.

Përveç ngritjes së cilësisë dhe të efikasitetit të mësimit, rimëkëmbja e shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë do të justifikonte edhe ekzistencën e studimeve në Degën e Pedagogjisë. Kjo për faktin se do të rritej kërkesa për veprimtarinë e kësaj dege, si për formimin e kuadrove të reja profesionale për shkollë dhe për institucione të tjera.

2.9 Fushat e punës dhe të aktivitetit të shërbimit të pedagogjik në shkollë

Këto fusha janë si vijon:

1. Planifikimi, programimi dhe organizimi i punës edukativo arsimore

- I udhëzon dhe bashkëpunon me mësimdhënës në përpilimin e planit dhe të programit të punës mësimore.
- Ndhmon në përpilimin e planit operativ vjetor dhe mujor.
- Merr pjesë në punën rreth regjistrimit të nxënësve në klasë të parë.
- Ndhmon në organizimin e dhe në mbajtjen e mësimit plotësues, vazhdues dhe të shtuar,
- Planifikon dhe organizon ligjërata nga kurset e ndryshme, duke i ftuar edhe profesionistët e tjerë, me qëllim të ngritjes së efikasitetit sa më të lartë të punës mësimore etj.

2.10 Realizimi i punës edukativo-mësimore

- Ofron ndihmë mësimdhënësve në konceptimin didaktiko – metodik të mësimit, duke iu preferuar strategji të reja të mësimdhënies, metodat mësimore, format e punës etj.
- U ndihmon mësimdhënësve për ta rinovuar mësimdhënien me mësim aktiv, me më shumë forma kooperative të mësimit, duke nënkuptuar këtu mësimdhënien dhe nxënien individuale dhe të individualizuar, pastaj mësimin ekzemplar, problemor etj.
- Inicion dhe merr pjesë në procesin e ngritjes së cilësisë dhe të nivelit të diturive të nxënësve, si dhe në aftësimin e nxënësve për zgjidhjen e problemeve.
- Njofton mësimdhënësit me inovacionet didaktike metodike dhe ndihmesa për t'i inkorporuar në praktikë.
- Ndhmon kujdestarin e klasës për kryerjen me sukses të detyrës së tij si edukatorë dhe udhëheqës i klasës.

- Ndhmon familjen dhe shkollën për të mos braktisur shkollën nga nxënësit.
- Parandalon shfaqjen e pengesave të nxënësve për të nxënë. • Ndhmon nxënësit me nevoja të veçanta.
- Parandalon abuzimet, përdorimin e lëndëve narkotike, trafikimin etj.
- Ndhmon për t'i zgjidhur konfliktet etj.

2.11 Puna me mësimdhënës

- I ndihmon çdo mësimdhënësi të sigurojë kushte të nevojshme për mësimdhënie dhe nxënie.
- I mundëson çdo mësimdhënësi që të identifikojë sa më herët te nxënësit përparësitë dhe mangësitë e tyre.
- U ndihmon mësimdhënësve në përpilimin e programit të punës edukative që u dedikohet nxënësve në harmoni me nevojat aktuale të bashkësisë së klasave.
- U ndihmon mësimdhënësve që t'ia krijojnë çdo nxënësi mundësinë për të marrë pjesë në punën e pavarur mësimore, zgjidhjen e problemeve dhe në marrjen e vendimeve.
- Motivon çdo mësimdhënës që të bashkëpunojë me punën e shërbimit pedagogjik të shkollës.
- Mundëson dhe e motivon çdo mësimdhënës që të koordinojë bashkëpunimin e shkollës me komunitetin
- U ndihmon mësimdhënësve që të krijojnë një bashkëpunim të volitshëm e kolegjal në mes vete.

2.12 Puna me nxënës

- U ndihmon ta njohin, të kuptojnë dhe të pranojnë vetën, dinjitetin e tyre, duke i orientuar në shfrytëzimin e mundësive të tyre për përparime të vazhdueshme në shkollë.
- Krijon kushte të favorshme pedagogjike në shkollë për zhvillimin social, emocional, fizik e intelektual të të gjithë nxënësve.
- Ndhmon në edukimin dhe në socializimin e nxënësve.
- Kur është e nevojshme, ndihmon nxënësin në kapërcimin e vështirësive, qofshin ato emocionale, sociale dhe të tjera.
- Mbanë herë pas here ligjërata me nxënës për informim dhe orientin profesional të tyre. Puna me prindër

- U ndihmon prindërve që të krijojnë një atmosferë të volitshme dhe një qëndrim prindëror ndaj fëmijës.
- U ndihmon prindërve që ta koordinojnë bashkëpunimin shkollë – familje, për të qenë i suksesshëm ky bashkëpunim.
- Merr pjesë në mbledhjet e prindërve, sidomos të këshillit të prindërve.
- Merr pjesë në arsimimin pedagogjik- psikologjik të prindërve etj.

2.13 Puna hulumtuese

- Hulumton aspiratat, pritjet dhe motivet e nxënësve për orientimin e tyre në profesione të dëshirueshme.
- Vlerëson pjekurinë intelektuale të nxënësve të klasës së parë.
- Merr pjesë në analizën e suksesit në periodat e vitit shkollor.
- Hulumton teknikat dhe metodat që janë më të favorshme për një mësimdhënie sa më bashkëkohore e demokratike.
- Hulumton arsyet dhe shkaqet e mungesave të nxënësve në mësim.
- Hulumton raportin arsimtar – nxënës.
- Udhëheq dhe analizon dokumentacionin për punën e shkollës.
- Hulumton ngarkesën e nxënësve me obligime shkollore etj.

2.14 Bashkëpunimi me organet profesionale në shkollë

- Bashkëpunon me institucionet arsimore, sociale e shëndetësore, si dhe me institucionet e tjera që i kontribuojnë realizimit të qëllimit dhe detyrave të punës edukativo-arsimore në shkollë.
- Ndihmon në përpilimin e planit dhe të programit të përsosjes profesionale të mësimdhënësve, edukatorëve dhe të bashkëpunëtorëve të tjerë profesionalë në shkollë.
- Ndihmon në realizimin e programit në përsosjen pedagogjike - psikologjike e metodike të mësimdhënësve.
- Bashkëpunon me qendrat për orientim profesional etj.

2.15 Bashkëpunimi me drejtorin

- Zhvillon bashkëpunimin me drejtorin, duke i nënkuptuar fushat e përbashkëta të punës.

- Konsultohet gjithnjë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përparimin e punës edukativo-arsimore të shkollës.
- Ndhmon në shqyrtimin e problemeve profesionale pedagogjike, të cilat kërkojnë zgjidhje etj. Këto dhe detyra, apo fusha të veprimtarisë së shërbimit pedagogjik në shkollë mund të shërbejnë edhe si program i punës së tij në shkollë. Përfundim Për nevojën, detyrat dhe domosdoshmërinë e punësimit të këtij shërbimi në institucionet tona shkollore e ndjejmë të nevojshme ta themi edhe këtë:
 - Mësimdhënësit kanë mbetur pa ndihmën pedagogjike në shkollë.
 - Dikur kishim Entin Krahinor për Përparimin e Shkollave, kishim entet pedagogjike me këshilltarë pedagogjikë në çdo qytet të Kosovës, kishim edhe pedagogët e shkollave dhe mësimdhënës që kishin mësuar lëndët pedagogjike.
 - Arsimtari i shkollës sot ka mbetur pa mbështetje pedagogjike, didaktike dhe metodike, i izoluar dhe pa pasur mundësi të kërkojë ndihmë, këshilla dhe mësim për punën edukativo arsimore me nxënës.
 - Për këtë arsye shkolla jonë sot ka nevojë për pedagogun dhe psikologun shkollor më shumë se kurrë më parë.
 - Shkollës sot i janë shtuar detyrat, obligimet dhe kërkesat e ndryshme, që nuk mund të realizohen me sukses pa ndihmën e shumanshme profesionale të profileve të ndryshme shkencore.
 - Pra shkolla jonë sot ka nevojë, jo vetëm për pedagogun e psikologun, por edhe për punëtorin social dhe mjekun e shkollës, që bashkërisht dikur quheshin shërbimi profesional (pedagogjik-psikologjik) i shkollës. Duke parë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e këtij shërbimi për shkollën, besojmë se institucionet tona, veçmas Ministria e Arsimit do ta marrë për bazë nevojën e themelimit të këtij shërbimi në shkolla, për të pasur rezultate më të mëdha në mësimdhënie, nxënie dhe në vlerësimin e arritjeve të nxënësve.

2.16 Roli i organeve drejtuese të shkollës

Shkolla është organi i cili funksionon si rezultat i organizimit të brendshëm të saj. Ajo përbëhet prej organeve qeverisëse dhe profesionale.

Organet qeverisëse të shkollës janë: drejtori, zëvendës drejtori dhe këshilli drejtues i shkollës.

Roli i organeve qeverisëse të shkollës është që të punojnë së bashku për të krijuar mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm si në aspektin e infrastrukturës fizike, po ashtu edhe në aspektin

emocional, social dhe në aspektin e zhvillimit të vlerave të besimit në vetvete, barazisë, tolerancës etj.

Drejtori dhe këshilli drejtues i shkollës mund të marrin vendime për trajtimin e temave për situata të rrezikshme për nxënësit, qoftë delikuencën, dhunën fizike, drogat, rreziqet nga interneti, trafikimi i qenieve njerëzore, nëse ata i konsiderojnë si emergjente çështjet e caktuara më lart. Ata mund t'ju propozojnë mësimdhënësve trajtimin e këtyre çështjeve por edhe të marrin masa sigurie në nivel shkolle. Mund të kontribuojnë edhe në menaxhimin e brendshëm të shkollës, duke i evituar praktikat jo të suksesshme të menaxhimit, gjithashtu mund të bashkëpunojnë me komunitetin në çështje të caktuara, komunën, policinë, OJQ, mjeksinë familjare, etj.

2.17 Teoria dhe praktika e bashkëpunimit të shkollës me familjen

Shkolla ka filluar të funksionojë si një institucion i ngritur enkas për t'u marrë me arsimimin dhe edukimin e fëmijëve, gjë të cilën prindërit nuk kanë mund ta kryejnë për një varg arsyesh: mungesë kompetence, mungesë kohe, kosto e lartë, etj. Shkolla si institucion është zhvilluar në vazhdimësi. Përgjatë zhvillimit të saj si institucion shkolla ka ardhur duke u ndërgjegjësuar gjithnjë e më shumë për pamundësinë e përballimit veçmas të detyrës së edukimit. Kështu ajo filloi përfshirjen e familjes brenda saj. Ekzistojnë programe me qasje të ndryshme lidhur me përfshirjen e familjes në shkollë përmes të cilave synohet parandalimi por dhe promovimi i sjelljes sociale pozitive. “Në literaturë gjejmë se përfshirja e prindërve në shkollë daton nga viti 1920, ku kjo përfshirje ishte përqendruar si një çështje globale për fëmijët e shteteve”. “Në vitet 1960 roli i familjes dhe shkollës në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve ishin të ndara dhe të dallueshme”⁴⁰. Ndërsa, “në vitin 1970 fillon lëvizja efektive në bashkëpunimin shkollë-familje, vite gjatë të cilave kishte mjaft debate në këtë drejtim”⁴¹. Më 1980 janë dhënë prova evidente se prindërit ishin të rëndësishëm për suksesin në shkollë, ku shkolla mori iniciativa për krijimin e modeleve për një bashkëpunim të suksesshëm shkollë-familje⁴². Më vonë, “duke u rritur ndjeshëm numri i nënave të arsimuara doli nevoja që të ndryshojë edhe mënyra se si mësuesit i shohin prindërit dhe si prindërit i shohin mësuesit, dhe si nëna përfshihet në edukimin e fëmijës”, (cituar në Amaral. D. 2003. Edhe tek ne, historikisht shkolla, familja dhe komuniteti shërbyen si shtyllë kryesore e shoqërisë kosovare (Koliqi, 2000). Edhe sot, bashkëpunimi shkollë-familje është sa aktual aq dhe i rëndësishëm si për mësimdhënësin ashtu edhe për familjen dhe komunitetin, sidomos në këtë kohë, kur e dimë se kurrësi shkolla nuk mundet dot t'ia dalë e vetme me nxënësit, në këtë rrugë të gjatë ku “shkolla është okupimi kryesor në rreth 13% të 18

viteve të para të jetës”⁴⁵. Nëse i hedhim një vështrim historik shkollës sonë do të shohim se familja ka qenë e përfshirë në shkollë në një masë shumë të vogël. Takimi i familjes me shkollën/mësuesit ka ndodhur vetëm gjatë takimeve/mbledhjeve me prindërit që zakonisht organizohen një herë në semestër. Ky raport ndryshon falë studimeve në fushën e bashkëpunimit shkollë-familje.

Mbledhjet e prindërve, realizohen ndërmjet familjes dhe mësuesit apo dhe shkollës (stafit të konsulencës). Këto mbledhje organizohen në nivel klase dy herë gjatë një semestri. Këto janë mbledhje informative, ku familja informohet për jetën dhe punën në shkollë, për suksesin/arritjet e nxënësit, për organizime të ndryshme nga shkolla etj. Këto takime kanë karakter të përgjithshëm. Kjo formë e bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes është e paraparë edhe në ligjin për arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë.

Takimet individuale me prindërit realizohen me iniciativën e shkollës (mësuesit, psikologut, mjekut...) ose të vetë prindit. Këto takime realizohen ndërmjet mësuesit dhe prindit apo prindërve (në çifte). Kjo është një formë e drejtpërdrejtë e kontaktit mes shkollës dhe familjes. Këto takime janë shumë konfidenciale dhe mundësojnë një bashkëbisedim mjaft të hapur, të sinqertë, të besueshëm, etj. Duke krijuar kështu dhe afërsi më të madhe ndërmjet shkollës dhe familjes. **Vizita në shtëpi**, është një nga praktikatat e bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes tek ne. Kjo mundësi bashkëpunimi mundëson marrjen e informacioneve nga familja për çështje në interes të shkollës, duke u njohur kështu më mirë me rrethanat familjare, marrëdhëniet e saj me nxënësin, etj. Një formë bashkëpunimi/praktike tek ne është dhe ajo e **telefonatave**. Kjo praktikë e bashkëpunimit të familjes dhe shkollës mundëson këmbimin e “informacioneve fillestare apo dhe shtesë për ndonjë aktivitet duke filluar nga faza e përgatitjes, gjatë dhe pas realizimit të tij. Kjo vlen për ekskursionet, pushimet, shëtitjet, organizimet e garave apo veprimtaritë shkollore, komunitare e familjare, etj.”. Gjithashtu, telefonatat mund të realizohen edhe me kalendar të përcaktuar “një herë në muaj”. Një praktikë bashkëpunimi mes shkollës dhe familjes tek ne është edhe **komunikimi me shkrim në mënyrë elektronike** përmes email-eve, mesazheve telefonike apo edhe përmes postës.

2.18 Praktikatat e bashkëpunimit të shkollës dhe familjes në përballimin e dhunës ndërmjet nxënësve

Bashkëpunimi efektiv mes shkollës dhe familjes në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve duhet të ndërtohet mbi një vizion të qartë. Nuk mund të imagjinohet se mund të arrihen rezultate gjatë këtij bashkëpunimi nëse shkolla nuk ka një strategji të përcaktuar veprimi në këtë drejtim,

strategji gjithëpërfshirëse kundër dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, me të cilën nënkuptojmë përfshirjen e nxënësve, familjes dhe shkollës. Strategjitë kundër dhunës ndërmjet nxënësve madje duhet të ekzistojnë edhe në nivel shtetëror. “Shkollat e përgjegjshme dhe të sigurta kanë plane dhe procedura në vend që të merren me sjellje të dhunshme dhe shkatërruese”. Në këtë pjesë të studimit do njihemi me disa nga programet e shkollës të cilat mund të zvogëlojnë rrezikun nga dhuna ndërmjet nxënësve dhe ta parandalojnë atë përmes strategjive të ndryshme, si zbatohen ato dhe cili është efektiviteti i tyre. Një mënyrë trajtimi - parandalimi e dhunës tek nxënësit është aplikimi i përbashkët i të dy planeve, ai psikoedukativ dhe ndërhyrja në shëndetin mendor me qëllim parandalimin e agresionit të të rinjve në shkollë. Kjo qasje trajtimi arsyetohet me faktin se mësuesit dhe administratorët e shkollave nuk kanë trajnim psikologjik e mos të flasim për parandalim të dhunës dhe vlerësim të rrezikut, pra ka nevojë të ngutshme për një program të tillë dhe kurrikulat të cilat mund të imponohen në mjediset të shkollës për zbatim nga mësuesit, personelit udhëzues (Erickson & Megivern, 2006). Një praktikë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve është edhe ajo përmes artit.

Dy nga qasjet e suksesshme janë: a) trajnimi i aftësive për njohjen e sjelljes b) trajnimet për ndikimet nga efektet e ekspozimit të dhunës. Këto dy kategori qasjeje për parandalimin e dhunës bazohen në shpjegime të ndryshme teorike – njëra te të menduarit e çrregullt dhe tjetra te emocionet e trazuar. Këto dy qasje synojnë të parandalojnë dhunën duke ndërhyrë/trajtuar sjelljet e çrregulluara të nxënësve, Chris D. Erickson, Ph.D. a Monica M. Megivern, Ed.D. (2006) 56. Qasje kjo shumë e arsyeshme e shkollës për parandalimin e dhunës duke ditur se “ sjellja e dhunshme është një simptomë e zakonshme e shumë shqetësimeve të shëndetit mendor, që përfshin çrregullimet si pasojë e abuzimit me substancat, pasojat nga traumat, çrregullime të stresit post-traumatik, çrregullimet bipolare dhe çrregullimet opozitare sfiduese. Është e njohur se më pak se një në pesë prej të gjithë fëmijëve me çrregullime të shëndetit mendor janë diagnostifikuar apo trajtohen”. Kjo strategji ka për qëllim parandalimin e agresionit tek të rinjtë. Programet për ndërhyrjen te ngacmimet e nxënësve janë pjesë e përpjekjes së përgjithshme për parandalimin e dhunës, të cilat synojnë të eliminojnë ngacmimin, të parandalojnë zhvillimin e problemeve të reja ngacmuese, të arrihen marrëdhënie më të mira mes kolegëve në shkollë, të krijohet klimë pozitive në shkollë, dhe të rritet sjellja e kujdesshme ndaj viktimës së ngacmimeve nga bashkëmoshatarët dhe të rriturit. Një përpjekje për reduktimin e dhunës tek nxënësit në shollë është dhe ajo përmes planifikimit sistematik. Kjo qasje maksimizon shanset për ndërhyrje të suksesshme dhe përfshin pesë elemente: a) identifikimi i problemit; b) kërkon të identifikohen programet dhe procedurat që adresojnë nevojat e nxënësve në të gjitha nivelet e

ekspozimit të dhunës në shkollë. c) analizimi problemit, d) propozim i reagimit, e) implementimi i reagimit.

Një mënyrë parandalimi të dhunës është ajo përmes kurrikulave, duke e bërë parandalimin pjesë e tyre. Këto programe përfshijnë udhëzime dhe diskutime për të ndryshuar perceptimet, qëndrimet dhe aftësitë e nxënësve.

2.19 Studimet për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë

Janë të shumta studimet për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë. “Studimet e para në fushën e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë u kryen në fund të viteve të 60-të të shekullit të kaluar në Suedi, dhe ky trend pastaj do të vazhdojë edhe në vendet e tjera skandinave, për shkak se dhuna në shkollë në këto vende ishte bërë problem dominant”.

Ndërsa analizat e para shkencore për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë janë bërë në vitet 80-të, dhe arsye ishte sidomos fakti se në Norvegji disa nxënës të shkollës fillore kishin kryer vetëvrasje për shkak të dhunës së ushtruar ndaj tyre nga bashkëmoshatarët, Marzeku (2012). Dhuna është problem global. “Prezenca e dhunës ndërmjet nxënësve (moshatarëve) është konstatuar në gjithë botën dhe është hulumtuar kudo në Evropë, SHBA, Austri, Zelandë të Re, Japoni, etj. Sipas një pasqyre, rezultati për ekspozimin e dhunës që është fituar nga studimet e bëra në Austri, Angli, Finlandë, Gjermani, Norvegji dhe SHBA – luhetet nga 15% deri në 25%. (cituar nga Marzeku, 2012), Ndërsa në SHBA është realizuar një studim në nivelin kombëtar, ku janë përfshirë rreth 16.000 nxënës nga klasa e 6-të deri në të 10-tën, në të cilin del se rreth 30% e nxënësve janë përfshirë në dhunë të përsëritur, 13% si dhunues, 10,6% si viktimë, ndërsa 6% si viktimë dhe si dhunues (T, Nansel & Overpeck, M & Scheidt, P. 2001). Studimi i realizuar në Norvegji me nxënësit e grupmoshës 11-14 vjeç konstaton se më pak se 55% e nxënësve i keqtrajtojnë bashkëmoshatarët një herë në javë apo edhe më shpesh. Studimi gjen edhe se djemtë janë tre-katër herë më shumë dhunues se sa vajzat (Roland, E & Idsoe, Th. 2001).

Në Kosovë janë bërë disa studime mbi dhunën ndaj nxënësve në shkollat e Kosovës, por jo edhe dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë. Një studim është kryer për dhunën ndaj nxënësve në shkollat nga UNICEF, i cili kishte për qëllim të hetonte natyrën dhe shtrirjen e dhunës ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës. Ky studim trajtoi dhunën ndaj fëmijëve nga arsimtarët, fëmijët e tjerë, si dhe dhunën nga prindërit. Për dhunën e ushtruar mbi nxënësit nga nxënësit e tjerë studimi ka gjetur se më pak se gjysma e nxënësve kanë deklaruar se të tjerët i përqeshin. Forma më e shpeshtë e dhunës nga bashkëmoshatarët është përqeshja dhe thirrja me emra fyes, e

përjetuar nga gjysma e të rinjve. Rreth $\frac{1}{4}$ e të anketuarve janë lënduar fizikisht nga fëmijët e tjerë. Katër nga pesë fëmijët më të rritur kanë thënë se dhuna më e madhe paraqitet ndërmjet fëmijëve të klasave të ndryshme, duke treguar kështu se rivaliteti ndërmjet klasave mund të jetë një burim i dhunës në shkollë. 39% e fëmijëve deklaruan se ka pasur dhunë ndërmjet nxënësve nga e njëjta klasë. Nxënësit raportojnë se janë të frikësuar nga bashkëmoshatarët e tyre, të cilët janë të dhunshëm apo agresivë (zakonisht fëmijët më të fortë fizikisht). Në këtë studim, sa i përket dhunës fizike, 415 e të anketuarve kanë thënë se bashkëmoshatarët i kanë goditur ose kanë përdorur dhunë, ndërsa 58% e të anketuarve kanë thënë se kurrë nuk janë injoruar ose neglizhuar nga fëmijët tjerë. 13% e fëmijëve të anketuar kanë thënë se të paktën një herë janë prekur nga fëmijët e tjerë, ose janë puthur ose ju kanë hequr rrobat me force. Raport: Studim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës. Maj-Shtator, (2005). Ndërsa në doracakun e botuar nga KEC dhe UNICEF, i cili kishte për objektiv krijimin e rrjetit të fuqishëm mbrojtës që do të kontribuojë në parandalimin e dhunës dhe krijimin e mjediseve të sigurta jo të dhunshme në shoqërinë Kosovare dhe në shkollë, gjejmë se: në disa vende përcillet edhe dokumentohet numri i vetëvrasjeve që janë pjesërisht edhe pasojë e keqtrajtimit të moshatarëve”⁸³. Në po të njëjtin tekst, ofrohen të dhënat nga studimi i realizuar në Kosovë ku raportohet se “keqtrajtimi i fëmijëve nga moshatarët e tyre paraqet problem në rritje në shoqërinë Kosovare.”. Në studimin tonë vëmendje e posaçme i është kushtuar faktorëve të cilët ndikojnë në prezencën e dhunës ndërmjet nxënësve, preokupim ky edhe tek studiuesi Lockwood (1997) i cili studioi faktorët që ndikojnë te dhuna ndërmjet nxënësve, si: marrëdhëniet midis antagonistëve, sekuenca e ngjarjeve në frekuentim, ku përfshihen qëllimet dhe arsyet e nxënësve të përfshirë në studim, gjithsej 110, në të cilin del se dhuna mes nxënësve ishte në nivelin 16% për sa i përket tipit, ku më të shprehura ishin fjalët fyese, gjuajtja me gjësende, shtyrjet, rrëmbimet, shpullat, goditjet me grusht, goditjet me objekte, kërcënimet me armë ose thikë. Më e shpeshta ishte goditja me grusht në dy të tretën e rasteve, përdorimi i thikës ndodhi më së paku në 2% të rasteve të shprehura në përqindje. Sa i përket vendndodhjes, rreth tre e katërta e incidenteve kanë filluar në shkollë. Rreth gjysma prej tyre janë zhvilluar në shkollë, palestër apo qendra rekreative. Sa i përket arsyes del se ishte për vetëmbrojtje apo për ti rezistuar kërkesave e antagonistit. Një studim tjetër mbi faktorët që ndikojnë në shtimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë është ai i kryer nga “Grunseit et. al (2005) ku është gjetur se pavarësisht se shkolla ka pasur një ndikim të qartë në dhunën ndërmjet nxënësve, faktorët individualë dhe familjarë janë të lidhur me dhunën që ushtrohet në mjediset shkollore”⁸⁶. Studimi tjetër mbi dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë trajton dhunën në totalin e nxënësve dhe vjen në përfundim se: “Përtej ndikimit të faktorëve individualë dhe kulturorë, në totalin e dhunës ndërmjet nxënësve, faktorët që lidhen me,

menaxhimin, organizimin apo kulturën e një shkolle, bënë një ndryshim të rëndësishëm për gjatat që një nxënës të përfshihet në dhunë, ose sjellje të pahijshme në shkollë”. Për dhunën ndërmjet nxënësve gjejmë dhe disa studime të tjera eksperimentale dhe jo-eksperimentale. Kështu, “në një studim jo eksperimental, studimi tregon se karakteristikat personale, besimet dhe qëndrimet, janë faktorë kyç nëse nxënësi përfshihet në sjellje të dhunshme”. Në studimet e tij Grunseit gjen se, përdorimi i dhunës në familje ka ndikim të fortë mbi tendencën që një i ri të jetë i dhunshëm. Sipas tij këtu kemi të bëjmë edhe me prindër të cilët e tolerojnë sjelljen e dhunshme. Te ky studiu del edhe ky faktor që ndikon në prezencën e dhunës te nxënësit. Sipas Grunseit shkolla mund të bëjë shumë për tu parandaluar dhuna mes nxënësve, por ajo varet nga shkalla se sa është e përkrahur dhuna brenda familjes dhe më gjerë (Working together, 2012). Në interesin tonë ishte të kuptojmë edhe faktin se dhuna manifestohet më shumë tek djemtë apo vajzat.” Dhjetë vitet e fundit, hulumtuesit kanë gjeneruar shumë studime empirike të agresionit tek vajzat në disa disiplina të ndryshme (psikologjia zhvillimore, psikiatria e fëmijëve dhe kriminalistika). Shumica e studimeve kanë identifikuar sjellje të çrregulluara si një gamë e rëndë mendore”. Në këtë drejtim është kryer një studim nga një grup autorësh ku, “në mesin e variablave të përfshira, problemi i ngacmimit del të jetë më i shpeshtë tek djemtë se sa te vajzat. Vajzat janë të përfshira më shumë në ngacmime psikologjike, ndërsa tek djemtë ngacmimi fizik është më i shpeshtë se tek vajzat”⁹⁰. Ndërsa, sa i përket moshës ngacmimi si sjellje është relativisht më i zakonshëm te fëmijët e të rinjtë se sa tek ata më të vjetër në moshë. (cituar në Pulido R., Martín Seoane G., Díaz Aguado M. J.2010). Te studimi i Pulido R., Martín Seoane G., Díaz Aguado (2010) , i cili kishte për qëllim të shqyrtonte rastet e situatave të dhunshme në një mostër përfaqësuese të realizuar me 1.635 studentë, variablat e matura ishin shpeshësia e dhunës në shkollë dhe statusi i kolegëve. Situatat më të shpeshta të dhunës duket se janë ato verbale dhe të përjashtimit, duke vijuar me agresionet verbale dhe dhuna kundër pronave. Përçindja e atyre që vuajnë situata ekstreme (si abuzimi seksual, kërcënimi me armë) të dhunës janë më të ulëta, por serioziteti i këtyre situatave e bën atë shumë të rëndësishme. Studimet e shumta për dhunën ndërmjet nxënësve tregojnë se dhuna ndërmjet nxënësve shkakton efekte negative në aspektin akademik, fizik, social, emocional e sidomos psikologjik të nxënësve. Pasoja këto afatshkurtra dhe afatgjata. Studimet për dhunën gjithashtu tregojnë se nxënësit të cilët kanë përjetuar dhënë në shkollë shfaqin sjellje si: ankthi, trishtimi, vetmia, pasiguria. Kemi dhe të tillë të cilët shfaqin sjellje eksternalizuese si hiperaktiviteti dhe impulsiviteti. Disa shfaqin dhe sjellje të tilla që përfshijnë frustrim, pikëllim dhe zemërim. Veç të tjerash, të gjitha këto arsye e bëjnë të domosdoshëm bashkëpunimit shkollë-familje për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

2.20 Studimet për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve

Gjatë shqyrtimit të literaturës kemi hasur në studime të shumta për dhunën dhe parandalimin e saj por të pakta për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Kryesisht fokusi i parandalimit të dhunës binte mbi dhunën e mësuesve ndaj nxënësve dhe atë të familjes ndaj fëmijës. “Studimet aktualisht nuk tregojnë ndonjë program ose praktikë të veçantë për reduktimin e dhunës” (cituar nga Working Together, 2010). “Si rezultat i arsyeve të ndryshme për bashkëpunim, ka shumë pak hulumtime dhe literaturë dhe pak literaturë të përgjithshme për bashkëpunimin midis shkollës dhe komunitetit, por nuk ekziston asnjë katalog i plotë”. “Edhe pse të dhënat janë të rralla, një konkluzion i arsyeshëm nga kërkimet e në dispozicion është se bashkëpunimi shkollë-komunitet mund të jetë me efektivitet dhe me kosto efektive afatgjatë”. Studimi i kryer nga Claire v.c; Scott, ; Katreena; Ellis; Wendy; Wolfe; David.A (2011) u krye me N = 1,722; 52.8% femra, në 20 shkolla. Në këtë studim janë marrë informacionet bazë: p.sh., gjinia, përvojat e keqtrajtimit të fëmijës dhe sjellja e dhunshme në klasë. Studimi kishte për objektivi të konstatojë se fëmijët me historik keqtrajtimi a kanë tendencë manifestimi të dhunës, duke synuar të konstatojnë nëse pjesëmarrja në një program bazë të shkollës për parandalimin e dhunës në klasën e 9-të vazhdon të japë efektin e ndikimit në aktet e dhunshme tek të rinjtë me histori keq trajtimi. Dy vjet pas ndërhyrjes tek këta fëmijë, zbulohet se te këta fëmijë edhe pse është ndërhyrë, aktet e dhunës vazhdojnë të manifestohen. Fuqia e kësaj marrëdhënie ishte dukshëm më e ulët në shkollat ku është ndërhyrë. Ndërsa, Bender & Emsilie, (2010), trajtojnë çështjen e parandalimit të dhunës mes nxënësve duke përfshirë stafin e shkollës, familjen dhe nxënësit. Ata përshkruajnë se si bashkëpunojnë anëtarët e stafit të shkollës, nxënësit, dhe prindërit për të parandaluar dhunën mes nxënësve në dy shkolla të mjedisit urban. Studim i tyre gjeti se në kundërshtim me besimin aktual, në mënyrë implicite nxënësit shprehën nevojën për mbështetjen e stafit të shkollës dhe këshillat e prindërve për t’u përballur me presionin nga ana e bashkëmoshatarëve, i cili mund të rezultojë në veprimet e tyre agresive ose të dhunshme në shkollë. Qasja e Rudolla (2011) për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve është përmes strategjive të mësimdhënies, duke u përqendruar në vlerësimin dhe reflektimin në mënyrë në mënyrë që të nxitet të mësuarit efektiv nga ana e nxënësve dhe rritet performanca e tyre akademike. Në studimin e tyre (John Lamanna, M. Ann Shillingford, Mary-Frances Parrish, and Rebecca Sheffield) hulumtuan ndikimin e dhunës psikologjike në K-12 studentë dhe rëndësinë e partneriteteve bashkëpunuese ndërmjet familjes dhe shkollës për zvogëlimin e efekteve dramatike nga ngacmimet mes nxënësve. Për parandalimin e dhunës në shkollë, studiuesit Sugai dhe Horner, rekomandojnë kulturë pozitive shkollore dhe programe radikale kundër dhunës. Kjo përfshin ndërtimin e kulturave të

kompetencave sociale të cilat mbështesin sjelljet pro sociale dhe maksimizojnë të mësuarit. Mjetet e auditimit që ndihmojnë personelin e shkollës dhe nxënësit të shqyrtojnë kulturën e tyre shkollore ose klimën si pjesë e një përgjigje ndaj dhunës studentore (cituar në Working together, 2010).

2.21 Faktorët e dhunës

Dhuna në shkolla mund të jetë e shumëllojshme, e nxitur dhe e shkaktuar nga shumë faktorë të ndryshëm. Faktorët kryesorë që ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit janë: faktorët biologjik, individual, lidhur me familjen, edukativë dhe arsimorë, shoqërorë, ekonomik dhe social (Patrick, 2008).

2.22 Llojet e dhunës

Llojet e dhunës që ushtrohen në individë ose në grupe janë të ndryshme, kjo varet nga qëllimi dhe mjetet me të cilat shkaktohet dhuna por varet edhe nga natyra e pasojave të tyre. Dhuna mund të shfaqet në forma të ndryshme duke filluar si: dhunë fizike/trupore, verbale, neglizhim, keqtrajtim, ngacim në mes të bashkëmoshatarëve. Përveç këtyre, forma tjera të dhunës janë edhe dhuna seksuale, digjitale, psikologjike – emocionale (Burger, Strohmeier, Spröber, Bauman, & Rigby, 2015). Po ashtu Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH, 2002) e ndan dhunën në tre kategori të gjera: dhuna e drejtuar ndaj vetës, dhuna ndërpersonale dhe dhuna kolektive.

2.23 Faktorët me ndikim tek dhuna

Pasiguria dhe dhuna në shkolla është rezultat i ndikimit të faktorëve si:

2.23.1 Faktorët individualë - dija, qëndrimet, mendimet për dhunën, përdorimi i drogës dhe alkoolit, qenia dëshmitar i dhunës apo të qenurit viktimë e dhunës ndërpersonale, qasja ndaj armëve të zjarrit dhe armëve të tjera;

2.23.2 Faktorët që rrjedhin nga familja - mungesa e dashurisë dhe e mbështetjes prindërore; eksperiencia me dhunën në shtëpi; dënimi fizik dhe keqtrajtimi i fëmijëve; prindërit apo dhe vëllezërit e motrat, të përfshirë në sjellje kriminale;

2.23.3 Faktorët shoqërorë – pabarazia shoqërore-ekonomike, urbanizmi dhe mbipopullimi; zhvillimi i shpejtë ekonomik, shoqëruar me nivel të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve; ndikimet e mjeteve të informimit publik; normat shoqërore që përkrahin sjellje të dhunshme;

disponueshmëria e armëve; situata e paskonfliktit (MASH-T-UNICEF, 2005, f. 2). Shkolla duhet të ofrojë mjedise të sigurta dhe të shëndetshme që mbështesin mësimin dhe punën për të gjithë. Studimet tregojnë ekzistencën e një lidhje të drejtpërdrejtë mes të arriturave të nxënësve dhe të mjedisit shkollor në të cilin zhvillohet mësimi.

2.24 Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna sipas juridiksionit të Republikës së Kosovës

Ndëshkimi trupor ose çfardo forme tjetër e ndëshkimit është e ndaluar në të gjitha institucionet arsimore. Dhuna në Republikën e Kosovës është e sanksionuar në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitarë. Ligjet të cilat garantojnë të drejtën e arsimimit, deklarojnë se i gjithë procesi edukativo- mësimorë duhet t'i përshtatet aftësive, prirjeve dhe moshës së secilit nxënës. Rëndësi të veçantë këtu ka edhe bashkëpunimi i mirë midis mësuesve, drejtorëve, shkollave, nxënësve, prindërve si dhe sigurimi dhe përmirësimi i mirëqenies mendore dhe fizike të nxënësve. Përdorimi apo ushtrimi i dhunës sidhe përfshirja në dukuri negative pavarësisht llojeve të saj, sanksionohet edhe me ligjet të cilat rregullojnë të gjitha çështjet e arsimit në Republikën e Kosovës si: Ligji për Edukimin Parashkollor, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Ligji për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve Mësimore, Lekturës Shkollore dhe Dokumentacionit Pedagogjik etj. Përveç këtyre ligjeve ekzistojnë edhe ligje të tjera përmes së cilave sanksionohet përdorimi i dhunës si: Ligji i Policisë, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare si dhe Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale (Save the Children, 2017).

Çfarë roli mund të luajnë shkollat në parandalimin e dhunës?

Thjesht sigurimi i edukimit dhe aktiviteteve të organizuara për fëmijët mund të ndihmojë në parandalimin dhuna: Shkollat dhe sistemet arsimore mund të ndihmojnë duke inkurajuar prindërit dhe fëmijët të regjistrohen dhe të marrin pjesë. Pasja një arsimit cilësor mund të rrisë gjasat e gjetjes së fëmijëve punë me pagesë në moshë madhore dhe pjesëmarrja në aktivitete të organizuara mund ta bëjë më pak të mundshme që fëmijët do të përfshihen në sjellje apo dhunë agresive. Shkollat mund të jenë gjithashtu vende ideale për aktivitete që synojnë parandalimin e dhunës. Ata mund të përfshijnë shumë të rinj në të njëjtën kohë, duke ndikuar që herët në jetë. Mësuesit e aftë mund të ofrojë programe parandaluese të dhunës dhe të veprojë si model i rëndësishëm jashtë familjes ose jeta e komunitetit. Shkollat mund të arrijnë te prindërit, duke përmirësuar praktikën prindërore që mund të jenë të dëmshme për shëndetin dhe arsimimin e fëmijëve. Shkollat krijojnë mjedise ideale për të sfiduar disa nga dëmtimet shoqërore dhe kulturore normat (standardet ose modelet tipike ose të pritshme) që tolerojnë dhunën ndaj tyre të tjerët (për shembull, dhuna me bazë gjinore).

Roli i pedagogut ka ndryshuar dhe evoluar që nga futja e tyre në shkollat kroate. Sot theksohet kryesisht roli i inovacionit dhe udhëheqjes për të përmirësuar procesin arsimor, por nuk duhet të lihet pas dore, as ndikimi i tyre në formimin e personalitetit të studentëve. Përveç edukimit, shkolla gjithashtu ka një funksion edukativ, i cili përfshin ndihmimin e studentëve në zhvillimin e personalitetit të tyre, një imazh pozitiv për veten dhe mjedisin e tyre. Puna këshilluese e pedagogut në shkolla me kalimin e kohës është bërë një fushë jashtëzakonisht e rëndësishme e veprimtarisë së tij. Pedagogu luan një rol të rëndësishëm në këshillimin e të gjitha lëndëve të procesit arsimor - duke filluar nga nevojat e studentëve, prindërve dhe personelit të shkollës. Pedagog, puna profesionale e të cilit përfshin puna e këshillimit përballet me shumë sfida dhe njëra prej tyre është zotërimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme për të udhëhequr me sukses procesin e këshillimit. Në mënyrë që të arrihet kjo, kërkohet përmirësim i vazhdueshëm. Në punën e tij këshilluese në shkollë, pedagogu nuk vepron i vetëm. Ai është pjesë e shërbimit të këshillimit shkollor i cili duhet të jetë pjesë integruese e shkollës. Përveç pedagogut, shërbimi përbëhet gjithashtu nga një psikolog dhe logoped ose rehabilitues. Personeli këshillues duhet të jetë vazhdimisht i azhurnuar me ndryshimet në shkollë dhe në punën e tyre të fillojë me nevojat e lëndëve individuale të shkollës. Kjo kërkon bashkëpunim me menaxhmentin e shkollës, veçanërisht me mësuesit, pasi zhvillimi i studentëve varet shumë nga puna në klasë dhe marrëdhëniet me mësuesit. Nga kjo rrjedh se puna e një shërbimi këshillimi duhet të ndihmojë mësuesit të mësojnë se si të krijojnë një marrëdhënie me studentët, gjë që çon në rezultate më të mira të të nxënit. Një e tillë shërbimi i këshillimit i cili është i integruar në punën e shkollës dhe që merr parasysh nevojat e jetës së studentëve dhe mësuesve dhe karakteristikat e shkollës nuk mund të zëvendësohen nga asnjë ekstern.

KAPITULLI III

III.METODOLOGJIA

Tek pjesa metodologjike e hulumtimit është përfshirë struktura e ecurisë së hulumtimit në fjalë, duke përfshirë vetë metodat dhe instrumentet shkencore, hipotezat, variablat, popullacionin dhe mostrën, po ashtu mënyrën e interpretimit të të dhënave si dhe historikun e zhvillimit dhe përpunimit të vetë hulumtimit në stade. Kjo pjesë e temës ka për qëllim që të ofrojë informata rreth qasjes metodologjike të përdorur gjatë këtij studimi, rreth metodave të studimit, mostrës dhe procesit të hulumtimit. Në përputhje me formulimin e problemit janë zgjedhur edhe metodat e studimit, me anën e të cilave u është dhënë përgjigje pyetjeve që kanë të bëjnë me formulimin e problemit.

3.1 Qëllimi i hulumtimit

Si të arrijmë që familja si partneri më ndihmues i shkollës në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, të jetë më e pranishme në atje? Cila mund të jetë praktika më e mirë për shkollën për një përfshirje më të gjerë të familjes në shkollë me synim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve? Në këtë studim bëjmë përpjekje për gjetjen e këtyre përgjigjeve të cilat do ti prezantojmë në kapitujt vijues. Pra, qëllimi i studimit është të kërkojë rrugë të optimizimit të bashkëpunimit të shkollës me familjen për përballimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Në funksion të këtij qëllimi prezantohen një sërë aktivitetesh të cilët kanë të bëjnë me njohjen e përmasave të dukurisë së dhunës ndërmjet nxënësve, si dhe njohjen dhe nxjerrjen në pah të faktorëve që përcaktojnë nivelin e bashkëpunimit të shkollës me familjen. Ndër faktorët e shumtë me ndikim në këtë proces, në studim evidentohen: mirëpritja e familjes nga shkolla, komunikimi shkollë familje, informimi i familjes nga shkolla, mbështetja e suksesit të nxënësve, ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes, vendimmarrja e familjes në shkollë, përvoja e mëparshme e bashkëpunimit të familjes me shkollën dhe besimi i familjes te shkolla.

3.2 Metodatat e hulumtimit

Në përgjithësi, gjatë këtij hulumtimi është përdorur qasja kuantitative hulumtuese. Kam zgjedhur për të përdorur qasjen kuantitative në hulumtim për faktin se përmes saj ka mundësi që problemi i cili hulumtohet të pasqyrohet me numra, përqindje dhe në mënyrë tabelore. Pasqyrimi i problemit në këtë mënyrë, mundëson që në mënyrë më objektive t'i përgjigjem edhe pyetjeve që kanë të bëjnë me formulimin e problemit. Gjithashtu, të dhënat kuantitative japin më shumë

mundësi për të krahasuar përgjigjet në mes grupeve brenda këtij studimi, por edhe për të krahasuar rezultatet e këtij studimi me ato të studimeve tjera të bëra nga kjo fushë. Varësisht distribuimit të të dhënave pastaj u vendos për llojin e analizave që do të përdorim: analiza parametrike dhe analiza jo-parametrike. Më pas vijnë në përdorim edhe statistikat konkluzive siq janë korelacioni analizë e cila ka të bëjë më ndërlidhjen ose ndërveprimin në mes të variablit të varur dhe variablit të pavarur.

3.3 Hipoteza e hulumtimit

Hipoteza kryesore e hulumtimit :

Ekziston një ndërlidhje pozitive në mes të mungesës së pedagogut dhe psikologut në shkollë, ndikimit të organeve drejtuese të shkollës në parandalimin e përfshirjes së nxënësve në dukuritë negative dhe abuzimit të tyre nga familjet.

H1: Ekziston një ndërlidhje pozitive në mes të marrëdhënieve të dobëta prindër – fëmijë. përdorimit të lojërave kompjuterike të dhunshme dhe rritjes së dhunës tek nxënësit.

H2: Nxënësit meshkuj shfaqin më shumë dhunë fizike se sa vajzat.

3.4 Popullacioni dhe mostra

Popullacioni apo mostra e këtij hulumtimi përfshinë të gjithë nxënësit e shkollave e mesme të ulta dhe të larta në Rajonin e Malishevës. Të dhënat statistikore për numrin e shkollave dhe numrin e nxënësve janë nga burimet zyrtare, përkatësisht nga MASHT “Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019”.

Malisheva ka gjithsej 3 shkolla të mesme të larta që ka mbi 3000 nxënës dhe mbi 9000 nxënës në shkollat e mesme të ulta. Kampionimi që përdoret në këtë hulumtim është kampioni i probabilitetit (i rastësishëm), me anën e të cilës do të tregojmë se është përfaqësues i të gjithë nxënësve të shkollave e mesme të ulta dhe shkollave të mesme të larta në Rajonin e Malishevës. Meqë numri i popullatës është shumë i madh është përzgjedhur mostra prej 200 respondentëve. Nxënësit e shkollave e mesme të ulta dhe të larta janë përzgjedhur me mostër të rastësishme – e llojit të hjeshtë e rastësishme ‘procesi zgjedhjes së mostrës që u mundëson pjesëmarrësve të popullatës të kenë mundësi të barabart dhe të pavarur që të jenë të përzgjedhur’ (Matthew, 2010).

3.5 Instrumentet e hulumtimit

Instrumenti i përdorur për realizimin e këtij hulumtimi është pyetësori i krijuar nga Mimoza Shahini (2011) “Opinionet mbi shkaktarët e dhunës dhe dukuritë negative në shkollë. Pyetësori

përmban dy pjesë, pjesa e parë përmban pyetjet demografike ndërsa pjesa e dytë përfshin 25 pyetje dhe përgjigjet me shkallë të Likerti (1- aspak nuk ndikon, 2 – pak ndikon, 3 – ndonjëherë ndikon, 4 – mesatarisht ndikon, 5 – ndikon shumë dhe 6 – gjithmonë ndikon). Kurse shkaktarët janë grumbulluar në bazë të origjinës së tyre: 1 - Faktorë të lidhur me familjen; 2 - Faktorë të lidhur me menaxhmentin në shkollë, 3 - Faktorë të lidhur me mjedisin e shkollës dhe rrugës për në shkollë; 4 - Faktorë të lidhur me mësimdhënësit dhe drejtorët (sjelljen dhe qëndrimin e tyre); 5 - Shkalla e influencës së internetit dhe filmave të dhunshëm në shprehjen e sjelljeve të dhunshme. Pyetësi do të jetë anonim, që pjesëmarrësit të ndjehen të sigurt dhe që informatat e tyre nuk do të keqpërdoren.

3.6 Dizajni i hulumtimit

Në këtë kapitull do ta prezantoj qasjen time për temën që kam përzgjedhur. Ky hulumtim është hulumtim kuantitativ, i cili ka për qëllim kryesor të tregoj se cilët janë faktorët e shfaqjes së sjelljes negative në shkolla: faktorë të lidhur me familjen; me menaxhmentin në shkollë, mjedisin e shkollës dhe rrugës për në shkollë; me mësimdhënësit dhe drejtorët (sjelljen dhe qëndrimin e tyre); me influencën e internetit dhe filmave të dhunshëm në shprehjen e sjelljeve të dhunshme. Përmes programit SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) do të bëhen analiza e të dhënave sasiore duke përdorur lloje të ndryshme të analizave siç janë: Analiza Deskriptive po ashtu edhe analiza inferenciale siç janë: H- katrorit, Krostabulimi, Korrelacioni dhe T –test.

3.7 Përpunimi statistikor i të dhënave

Përpunimi statistikor i të dhënave do të realizohet me paketën SPSS versioni 23 ku pyetjet hulumtuese do të testohen me anë të analizave të këtij programi. Varësisht distribuimit të të dhënave se a kemi distribuim normal apo jo normal të të dhënave do të vazhdohet me analiza parametrike dhe joparametrike. Për analizimin e të dhënave do të përdorim korelacionin t testin dhe regresionin. Korelacioni ndahet në dy lloje në korelacionin e Pearsonit i cili përdoret nëse kemi distribuim normal si dhe korelacionin e Spearmanit nëse kemi distribuim jo normal të të dhënave. Analizat tjera do të përdorim analizat që kanë të bëjnë me dallimet e mesatareve siç janë t testi, independent t test si dhe simple t test. Përpunimi i të dhënave dhe analizave të hulumtimit do të bëhet me softëearin SPSS version më i fundit 23.

3.8 Nxierja e perfundimeve dhe rekomandimeve.

Duke u bazuar në shfletimin e literaturës dhe në hulumtime të shumta me temë të njejtë është vërtetuar për rolin e pedagogut dhe organeve drejtuese të shkollës në uljen e dukurive negative në shkollë. Studime të shumta tregojnë për rolin që ka shkolla në ngritjen e vetëdijes tek nxënësit lidhur me dukuritë negative dhe bashkëpunimin që ka shkolla me prindër për të luftuar këto dukuri.

3.9 Procedura dhe rrethanat e mbledhjes së të dhënave

Të dhënat statistikore për numrin e shkollave dhe numrin e nxënësve janë nga burimet zyrtare, përkatësisht nga MASHT “Statistikat e Arsimit në Kosovë”.

Kërkesën për hulumtim e kam përcjellë në Drejtoritë Komunale të Arsimit për shkolla të mesme të ultra dhe shkollat e mesme të larta që janë të përfshira në hulumtim.

Pasi kam marr lejen që të bëjë hulumtimin në shkolla, jam takuar me nxënësit të cilët do janë përzgjedhë në mënyrë të rastësishme, kjo procedurë zgjati 15-20 ditë.

Të gjitha të dhënat janë anonime apo konfidenciale, po ashtu është respektuar respondentin nëse i njëjti nuk do të marrë pjesë në hulumtim.

3.10 Kufizimet e studimit

Ky studim mund të jetë i kufizuar nga faktorët e mëposhtëm: 1. Mësuesit mund të jenë të kujdesshëm në dhënien e informacionit në bashkëpunim me familjen. Është e vështirë t'i shmangemi subjektivitetit të mësuesve në dhënien e përgjigjeve për bashkëpunimin mes tyre dhe familjes. 2. Gjithashtu kufizim në dhënien e sinqertë të përgjigjes mund të hasim edhe nga familja. 3. Kufizimet e studimit lidhen edhe me karakterin e vetë problemit. Duke pasur parasysh faktin se dhuna ndërmjet nxënësve manifestohet me përjetime të pakëndshme, nuk është e lehtë që nxënësit të flasin për dhunën me nxënësit e tjerë. Veç kësaj, ekziston dyshimi tek nxënësit lidhur me etikën profesionale të studiuesit se të dhënat e tij mund të mos mbeten konfidenciale, ndërkohë që është e pakëndshme të flitet për dhunën, etj. 4. Një kufizim i studimit lidhet me fokus grupet ku janë përfshirë nxënës të dhunshëm dhe nxënës të dhunuar, që ka përbërë rrezik për nxitjen e ngacmimeve ndërmjet tyre. 5. Një kufizim serioz është edhe mungesa e studimeve të detajuara për dhunën ndërmjet nxënësve tek ne. Pavarësisht kufizimeve të lartpërmendura në këtë studim janë bërë përpjekje që problemi të operacionalizohet në çështje shumë konkrete dhe realistemos u interesuar për jetën e fëmijëve në shkollë 3. Komplexiteti që krijon dhuna në shkollë është herë pas here çështja më e komplikuar për shkollën dhe familjen.

KAPITULLI IV

IV.REZULTATET E PRITURA

Fillimisht kemi vazhduar me kodimin e të dhënave për metodën kuantitative me ç'rast do të bëhen analizat adekuate: Fillimisht është bërë testi i normalitetit për të parë distribuimin e të dhënave në mënyrë që të vazhdohet me analiza parametrike ose jo parametrike. Pas analizimit të të dhënave varësisht se si do të rezultojnë të dhënat a kanë shtrirje normale bazuar në testin e Shapiro - Wilk dhe testin e Kolmogorov - Smirnov cili rezultoi $p > .05$. Bazuar në këto rezultatet ne kemi vazhduar me analiza parametrike, me korrelacionin e Pearsonit, t-testin dhe regresionin.

Nga ky hulumtim pritet që të kuptohet:

- Shkaktarët e dhunës në shkollë janë problemet familjare të nxënësit.
- Faktorët që ndikojnë në parandalimin e dukurive negative të nxënësit.
- Të kuptohet korrelacioni në mes dy variablave, variablit të pavarur që ka të bëjë me shkaktarët e dhunës në shkolla si dhe të variablit të varur, që ka të bëjë me sjelljen

negative të nxënësve.

Tabela 1. Pyetësi mbi shfaqjen e dhunës tek nxënësit

Reliability Statistics	
Cronbach's	
Alpha	N of Items
.879	38

Analiza e Cronbach's Alphas mbi pyetësin e shfaqjes së dhunës tek nxënësit ka rezultuar $n=38$ ($\alpha = .879$) që tregon se ky pyetësor ka një besueshmëri të lartë dhe e mat qëllimin e këtij hulumtim.

Tabela 2. Pyetësi mbi marrëdhëniet familjare sipas përcetimeve të nxënësve

Reliability Statistics	
Cronbach's	
Alpha	N of Items
.922	20

Analiza e Crombach's Alphas mbi pyetësorin mbi marrëdhëniet familjare sipas përcetimeve të nxënësve ka rezultuar $n=20$ ($\alpha = .922$) që tregon se ky pyetësor ka një besueshmëri shumë të lartë dhe e mat qëllimin e këtij hulumtimi.

Tabela 3. Pyetësori mbi shfaqjen e dhunës perceptimet nga prindërit

Reliability Statistics	
Cronbach's	
Alpha	N of Items
.756	26

Analiza e Crombach's Alphas mbi Pyetësori mbi shfaqjen e dhunës perceptimet nga prindërit ka rezultuar $n=26$ ($\alpha = .756$) që tregon se ky pyetësor ka një besueshmëri të lartë dhe e mat qëllimin e këtij hulumtimi.

Tabela 4. Pyetësori mbi marrëdhëniet familjare sipas përcetimeve të prindërve

Reliability Statistics	
Cronbach's	
Alpha	N of Items
.756	26

Analiza e Crombach's Alphas mbi pyetësorin mbi marrëdhëniet familjare sipas përcetimeve të prindërve ka rezultuar $n=26$ ($\alpha = .756$) që tregon se ky pyetësor ka një besueshmëri të lartë dhe e mat qëllimin e këtij hulumtimi.

Tabela 5. Pyetësori mbi shfaqjen e dhunës perceptimet e mësimdhënësve

Reliability Statistics	
Cronbach's	
Alpha	N of Items
.844	20

Analiza e Crombach's Alphas mbi pyetësori mbi shfaqjen e dhunës perceptimet e mësimdhënësve ka rezultuar $n=20$, ($\alpha = .844$), që tregon se ky pyetësor ka një besueshmëri të lartë dhe e mat qëllimin e këtij hulumtimi.


Tabela 6. Pyetësi mbi marrëdhëniet familjare përceptimet e mësimdhënësve

Reliability Statistics	
Cronbach's	
Alpha	N of Items
.764	20

Analiza e Cronbach's Alphas mbi pyetësi mbi marrëdhëniet familjare përceptimet e mësimdhënësve ka rezultuar $n=20$, ($\alpha=.764$) që tregon se ky pyetësor ka një besueshmëri të lartë dhe e mat qëllimin e këtij hulumtimi.

Tabela 7. Frekuenca mbi gjinijen e pjesëmarrësve nxënës në hulumtim.

1.Cila eshte gjinia juaj?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	mashkull	37	37.0	37.0	37.0
	femer	63	63.0	63.0	100.0
	Total	100	100.0	100.0	




Grafiku 1. Frekuenca mbi gjininë e pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit në këtë hulumtim kanë qenë 100 nxënës nga dy shkolla të ndryshme të komunës së Malishevës, ndërsa ndarja sipas gjinisë ka qenë 37 meshkuj dhe 63 femra. Mesatarja për gjini ishte $M=1.63$ dhe devijimi standard $DS=.48$

Tabela 8. Frekuenca mbi moshën e pjesëmarrësve nxënës në hulumtim.

2. Cila eshte mosha juaj?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	13 vjeç	24	24.0	24.0	24.0
	14 vjeç	24	24.0	24.0	48.0
	15 vjeç	52	52.0	52.0	100.0
	Total	100	100.0	100.0	




Grafiku 2. Frekuenca mbi moshën e pjesëmarrësve.

Nxënësit pjesëmarrës sipas moshës kanë qenë gjithsej 100 pjesëmarrës prej tyre 24 pjesëmarrës të moshës 13 vjeçar, 24 pjesëmarrës të moshës 14 vjeçar si dhe 52 pjesëmarrës të moshës 15 vjeçar apo gjimnazistë.

Tabela 9. Frekuenca mbi moshën e pjesëmarrësve mësimdhënës në hulumtim.


Cila është moshja juaj?				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
	54	54.0	54.0	54.0
27	1	1.0	1.0	55.0
28	1	1.0	1.0	56.0
29	2	2.0	2.0	58.0
30	4	4.0	4.0	62.0
31	2	2.0	2.0	64.0
32	3	3.0	3.0	67.0
33	2	2.0	2.0	69.0
34	2	2.0	2.0	71.0
35	3	3.0	3.0	74.0
36	4	4.0	4.0	78.0
37	1	1.0	1.0	79.0
39	1	1.0	1.0	80.0
40	4	4.0	4.0	84.0
Valid 42	1	1.0	1.0	85.0
45	1	1.0	1.0	86.0
46	1	1.0	1.0	87.0
47	1	1.0	1.0	88.0
48	1	1.0	1.0	89.0
49	1	1.0	1.0	90.0
50	1	1.0	1.0	91.0
52	1	1.0	1.0	92.0
57	1	1.0	1.0	93.0
58	1	1.0	1.0	94.0
60	2	2.0	2.0	96.0
61	2	2.0	2.0	98.0
62	1	1.0	1.0	99.0
64	1	1.0	1.0	100.0
Total	100	100.0	100.0	



Mësimdhënësit pjesëmarrës në këtë hulumtim kanë qenë gjithsej 46 pjesëmarrës nga dy shkolla të ndryshme të komunës së Malishevës prej tyre kemi pasur mësimdhënësin më të ri 27 vjeçar dhe mësimdhënësin më të vjetër 64 vjeçar.

Tabela 10. Frekuenca mbi shkollimin e pjesëmarrësve mësimdhënës në hulumtim.


Cili është shkollimi juaj?				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Shkolle e larte	4	8.7	8.7	8.7
Valid Fakultet	30	65.2	65.2	73.9
Magjistrature	12	26.1	26.1	100.0
Total	46	100.0	100.0	



Shkollimi i mësimdhënësve nga gjithsej 46 pjesëmarrës mësimdhënës në këtë hulumtim 4 apo 8.7 % prej tyre ishin me shkollë të lartë, 30 ose 65.2 % prej tyre me fakultet dhe 12 ose 26.1% prej tyre me gradën master.

Tabela 11. Frekuenca mbi gjininë e pjesëmarrësve prindër në hulumtim.

1.Cila është gjinia juaj?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	mashkull	34	34.0	62.9	66.7
	femer	20	20.0	37.1	100.0
	Total	54	54.0	100.0	



Frekuenca e gjinisë së pjesëmarrësve prindër në këtë hulumtim ishin 54 prindër prej tyre 34 meshkuj apo 62.9 % dhe 20 femra apo 37.1 %.

Tabela 12. Analiza e korelacionit të Pearsonit mbi hipotezën e parë.

Correlations					
			5. Mungesa e pedagogut dhe psikologut në shkollë ka ndikuar në rritjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit	4. Mënyra e edukimit të fëmijës	1. Familja e çorganizuar
5. Mungesa e pedagogut dhe psikologut në shkollë	Pearson Correlation	1		-.378*	.297**
	Sig. (2-tailed)			.000	.005

ka ndikuar në rritjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit	N	46	36	46
4. Mënyra e edukimit të fëmijës	Pearson Correlation	-.378*	1	-.443**
	Sig. (2-tailed)	.000		.002
	N	36	36	36
1. Familja e çorganizuar	Pearson Correlation	.297**	-.443**	1
	Sig. (2-tailed)	.005	.002	
	N	46	36	46

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

H1:“Ekziston një ndërlidhje negative në mes të mungesës së pedagogut dhe psikologut në shkollë, ndikimit të organeve drejtuese të shkollës në parandalimin e përfshirjes së nxënësve në dukuritë negative dhe abuzimit të tyre nga familjet”, hipotezë kjo e analizuar përmes analizës së korealcionit të Pearsonit dhe ka rezultuar vijon $[r = -.378^*, p = 0.00]$ lidhur me variablën e pavarur mungesa e pedagogut dhe psikologut në shkollë ndikon në sjellje të dhunshme dhe variables së varur mënyra e edukimit. Po ashtu mënyra e edukimit është e ndërlidhur me variablën e mungesën e pedagogut dhe psikologut në shkollë $[r = .297^{**}, p = 0.05]$. Po ashtu variabla mungesa e psikologut dhe pedagogut në shkollë është e ndërlidhur $[r = -.443^{**}, p = 0.02]$. Kjo hipotezë është analizuar dhe ka rezultuar si e saktë pasi që ekziston një ndërlidhje negative në mes të mungesës së pedagogut dhe psikologut në shkollë, ndikimit të organeve drejtuese të shkollës në parandalimin e përfshirjes së nxënësve në dukuritë negative dhe abuzimit të tyre nga familjet.

Tabela 15. Analiza e t - testit mbi hipotezën e dytë.

Correlations				
		6. Marrëdhëniet e dobëta prindër- fëmijë	4. Mënyra e edukimit të fëmijës	17. Lojërat e dhunshme kompjuterike
6. Marrëdhëniet e dobëta prindër- fëmijë	Pearson	1	-.517**	-.029*
	Correlation		.000	.003
	Sig. (2-tailed)			
	N	46	46	46
4. Mënyra e edukimit të fëmijës	Pearson	-.517**	1	-.205**
	Correlation			.002
	Sig. (2-tailed)	.000		
	N	46	46	46
17. Lojërat e dhunshme kompjuterike	Pearson	-.029*	-.205**	1
	Correlation		.002	
	Sig. (2-tailed)	.003		
	N	46	46	46

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

H2:“Ekziston një ndërlidhje negative në mes të marrëdhënieve të dobëta prindër – fëmijë. përdorimit të lojërave kompjuterike të dhunshme dhe rritjes së dhunës tek nxënësit”, hipotezë kjo e analizuar përmes analizës së korealacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar vijon $[r = -.517^{**} p = 0.00]$ lidhur me variablën e pavarur marrëdhëniet e dobëta prindër – fëmijë dhe variables së varur mënyra e edukimit. Po ashtu mënyra e edukimit është e ndërlidhur me variablën e përdorimit të lojërave të dhunshme $[r = -.205^{**}, p = 0.02]$. Po ashtu variabla marrëdhëniet e dobëta prindër-fëmijë është e ndërlidhur me variablën e përdorimit të lojërave të dhunshme $[r = -.029^* p = 0.03]$. Kjo hipotezë është analizuar dhe ka rezultuar si e saktë pasi që ekziston një ndërlidhje negative në mes të marrëdhënieve të dobëta prindër – fëmijë, përdorimit të lojërave kompjuterike të dhunshme dhe rritjes së dhunës tek nxënësit.

Tabela 16. Analiza e t testit mbi hipotezën e tretë.

Group Statistics					
1.Cila eshte gjinia juaj?		N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
7. Nxënësit meshkuj	Mashkull	33	5.2121	.99240	.17275
shfaqin më shumë dhunë fizike se sa femrat	Femer	13	4.3846	1.70970	.47419

Independent Samples Test										
		Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means						
		F	Sig.	T	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
									Lower	Upper
7. Nxënësit meshkuj	Equal variances assumed	6.661	.013	2.054	44	.046	.82751	.40284	.01563	1.63938
shfaqin më shumë dhunë fizike se sa femrat	Equal variances not assumed			1.640	15.296	.121	.82751	.50467	-.24637	1.90138

H3: Nxënësit meshkuj shfaqin më shumë dhunë fizike se sa vajzat, hipotezëkjo e cila është analizuar permes analizës së t-testit dhe ka rezultuar se kemi dallime gjinore në shfaqjen e dhunës tek femrat dhe meshkujt dhe si rezultat i kësaj analize kemi këto të dhëna ku meshkujt kanë predispozita më të larta për shfaqje të dhunës se sa femrat. Analiza e t-testit ka rezultuar në këtë vlerë për meshkuj M= 5.21 dhe DS= 0.99 ndërsa vlera për femra M= 4.38 dhe DS= 1.70.

KAPITULLI V. DISKUTIMI

Hulumtimi i realizuar mbi temën “Roli i pedagogut dhe organeve drejtuese lidhur me parandalimin e dukurive negative tek nxënësit”. Ky hulumtim ka për qëllim kryesor të tregojë se cilët janë faktorët e shfaqjes së sjelljes negative në shkolla: faktorë të lidhur me familjen; me menaxhmentin në shkollë, mjedisin e shkollës dhe rrugës për në shkollë; me mësimdhënësit dhe drejtorët (sjelljen dhe qëndrimin e tyre); me influencën e internetit dhe filmave të dhunshëm në shprehjen e sjelljeve të dhunshme, dhe përdorimit të duhanit, alkoolit, drogave etj. Ky hulumtim ishte i llojit kuantitativ dhe kishte pjesëmarrës të tri grupeve: nxënës, prindër dhe mësimdhënës/staf drejtues. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim ishin 200 pjesëmarrës prej tyre 100 nxënës, 54 prindër dhe 46 mësimdhënës/ staf drejtues i shkollës. Ky hulumtim u realizua me anë të instrumentit matës pyetësorit duke marrë për bazë edhe shfletimin e literaturës se cilat janë instrumentet më valide. Instrumenti i përdorur për realizimin e këtij hulumtimi është pyetësori i krijuar nga Mimoza Shahini (2011) “Opinionit mbi shkaktarët e dhunës dhe dukurive negative në shkollë. Pyetësori përmban dy pjesë, pjesa e parë përmban pyetjet demografike ndërsa pjesa e dytë përfshin 25 pyetje dhe përgjigjet me shkallë të Likertit (1- aspak nuk ndikon, 2 – pak ndikon, 3 – ndonjëherë ndikon, 4 – mesatarisht ndikon, 5 – ndikon shumë dhe 6 – gjithmonë ndikon). Kurse shkaktarët janë grumbulluar në bazë të origjinës së tyre: 1 - Faktorë të lidhur me familjen; 2 - Faktorë të lidhur me menaxhmentin në shkollë, 3 - Faktorë të lidhur me mjedisin e shkollës dhe rrugës për në shkollë; 4 - Faktorë të lidhur me mësimdhënësit dhe drejtorët (sjelljen dhe qëndrimin e tyre); 5 - Shkalla e influencës së internetit dhe filmave të dhunshëm në shprehjen e sjelljeve të dhunshme. Pyetësori do të jetë anonim, që pjesëmarrësit të ndjehen të sigurt dhe që informatat e tyre nuk do të keqpërdoren. Si rrjedhojë e shfletimit të literaturës erdhëm edhe deri tek pyetjet hulumtuese që ishin 3.

H1: “Ekziston një ndërlidhje negative në mes të mungesës së pedagogut dhe psikologut në shkollë, ndikimit të organeve drejtuese të shkollës në parandalimin e përfshirjes së nxënësve në dukuritë negative dhe abuzimit të tyre nga familjet”, hipotezë kjo e analizuar përmes analizës së korelacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar vijon $[r = -.378^*, p = 0.00]$ lidhur me variablën e pavarur mungesa e pedagogut dhe psikologut në shkollë ndikon në sjellje të dhunshme dhe variablen e varur mënyra e edukimit. Po ashtu mënyra e edukimit është e ndërlidhur me variablën e mungesës së pedagogut dhe psikologut në shkollë $[r = .297^{**}, p = 0.05]$. Po ashtu variabla mungesa e psikologut dhe pedagogut në shkollë është e ndërlidhur $[r = -.443^{**}, p = 0.02]$. Kjo hipotezë është analizuar dhe ka rezultuar si e saktë pasi që ekziston një ndërlidhje negative në mes të mungesës së pedagogut dhe psikologut në shkollë, ndikimit të organeve

drejtuese të shkollës në parandalimin e përfshirjes së nxënësve në dukuritë negative dhe abuzimit të tyre nga familjet.

H2:“Ekziston një ndërlidhje negative në mes të marrëdhënieve të dobëta prindër – fëmijë. përdorimit të lojërave kompjuterike të dhunshme dhe rritjes së dhunës tek nxënësit”, hipotezë kjo e analizuar përmes analizës së korealcionit të Pearsonit dhe ka rezultuar vijon [$r = .517^{**}$ $p = 0.00$] lidhur me variablën e pavarur marrëdhëniet e dobëta prindër – fëmijë dhe variablen e varur mënyra e edukimit. Po ashtu mënyra e edukimit është e ndërlidhur me variablën e përdorimit të lojërave të dhunshme [$r = -.205^{**}$, $p = 0.02$]. Po ashtu variabla marrëdhëniet e dobëta prindër-fëmijë është e ndërlidhur me variablën e përdorimit të lojërave të dhunshme [$r = -.029^*$ $p = 0.03$]. Kjo hipotezë është analizuar dhe ka rezultuar si e saktë pasi që ekziston një ndërlidhje pozitive në mes të marrëdhënieve të dobëta prindër – fëmijë, përdorimit të lojërave kompjuterike të dhunshme dhe rritjes së dhunës tek nxënësit.

H3: Nxënësit meshkuj shfaqin më shumë dhunë fizike se sa vajzat, hipotezë kjo e cila është analizuar përmes analizës së t-testit dhe ka rezultuar se kemi dallime gjinore në shfaqjen e dhunës tek fëmrat dhe meshkujt dhe si rezultat i kësaj analize kemi këto të dhëna ku meshkujt kanë predispozita më të larta për shfaqje të dhunës se sa femrat. Analiza e t-testit ka rezultuar në këtë vlerë për meshkuj $M = 5.21$ dhe $DS = 0.99$ ndërsa vlera për femra $M = 4.38$ dhe $DS = 1.70$.

KONKLUZIONE

Përfundime për faktorët me rëndësi në përfshirjen dhe bashkëpunimin e familjes me shkollën në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Për sa u përket faktorëve për përfshirjen dhe bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, ku dhe përqendrohet studimi ynë, del në pah fakti se mirëpritja dhe mbështetja e suksesit, janë faktorët më të realizuar nga shkolla për bashkëpunimin me familjen. Gjejmë gjithashtu se ekziston në nivel të lartë besimi i familjes te shkolla, faktor ky i rëndësishëm në bashkëpunim. Këto përfundime janë bazuar në qëndrimet e familjes dhe të shkollës. Që të dyja palët konsiderojnë se shkolla është në nivelin e duhur lidhur me këta faktorë. Rezultatet e studimit tonë përshkruen na shpjen në përfundimin lidhur me nivelin e faktorëve si: Mirëpritja e familjes në shkollë, Komunikimi i drejtë i shkollës ndaj familjes, Besimi i familjes te shkolla, Informimi i drejtë i shkollës drejt familjes, Mbështetja e suksesit të nxënësve, Ndarja e detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes, Përvoja e familjes me shkollën, Vendimmarrja e familjes në shkollë, të cilat i konsiderojmë të jenë shumë domethënëse për përfshirjen më të lartë të familjes në shkollë dhe bashkëpunimin e suksesshëm për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, duke supozuar kështu se përfshirja e familjes në shkollë në mënyrë të vazhdueshme përbën çelësin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Përfshirja e familjes në shkollë të bëhet në bazë të një programi bashkëpunues shkollë-familje. Nuk guxon që kjo përfshirje të jetë në baza individuale si nga mësuesit ashtu dhe familja, duke pasur kështu si rezultat përfshirjen vetëm të një pjese të familjes. Qasja e tyre në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve nuk guxon të jetë e ndarë, përderisa dihet se pa trajtimin pedagogjik të këtyre dy faktorëve në veçanti dhe të gjithë faktorëve të tjerë pjesëmarrës në edukimin e nxënësit si medieve, komunitetit, etj nuk mund të kemi rezultat e dëshiruara. Për këtë, rekomandojmë që shkolla të hartojë plane për përfshirjen efikase të familje në shkollë në konceptimin e të cilave duhet të jetë pjesëmarrëse edhe familja.

Familja të ndiejë se shkolla po punon në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, se ajo ka besim dhe ka nevojë për ndihmë. Nëse këto programe vijnë nga shkolla, efekti i tyre do jetë shumë më i madh se sa kur kanë origjinë në media, literatura, etj, pa e injoruar rëndësinë të dytave. Nëse shkolla punon pa programe për përfshirjen e familjes në shkollë, vështirë se përfshirja mund të ndodhë, vështirë se familja do të ndihet pjesë e domosdoshme e shkollës, ose kjo do ndodhë tek një numër shumë i vogël i tyre.

Programi i Ndërhyrjes për Sjelljet Pozitive (NSP) i ndihmon mësuesit të kuptojnë rëndësinë e menaxhimit të klasës dhe parandalimit të sjelljeve problematike në shkollë si dhe të nxisin

maksimalisht suksesin e nxënësve. Strategjitë e NSP -ve janë thelbësore për t'iu mundësuar të gjithë fëmijëve një mjedis sa më të mirë të të nxënësve. Një nga përparësitë më të mëdha të disiplinimit në shkollë është vënia e theksit në sistemet e mbështetjes me bazë të gjerë, që përfshijnë strategji proaktive për përcaktimin, mësimin dhe mbështetjen e sjelljeve të përshtatshme të nxënësve për të krijuar mjedise miqësore dhe pozitive shkollore. Në vend të përdorimit vetëm të një qasje bazuar në planet individuale të menaxhimit të sjelljes, zbatohet një mbështetje në vazhdimësi e sjelljes pozitive për të gjithë nxënësit, brenda një shkolle, duke përfshirë mjediset brenda dhe jashtë klasës (të tilla si klasat, korridoret, tualetet, mjediset e pushimit, oborri etj). Ndërhyrjet për Sjelljen Pozitive, NSP është një qasje proaktive për mbështetjen jo vetëm të sjelljes pozitive por edhe të promovimit të kulturës sociale e të nevojshme për të gjithë nxënësit për të siguruar mirëqenien sociale, emocionale dhe akademike të nxënësve. Kujdesi përqendrohet në krijimin dhe mbështetjen e sistemeve parësorë (me bazë shkollën), dytësorë (me bazë klasën) dhe sistemi i tretë (me bazë individin) që përmirësojnë rezultatet e jetesës (personale, shëndetësore, sociale, familjare, punë, krijimtari) për fëmijët, duke u fokusuar tek sjelljet problematike dhe sjellja e dëshiruar. NSP-të përbëjnë një sistem parandalimi që funksionon për të gjithë nxënësit. Ato janë hartuar si një alternativë kundrejt ndërhyrjeve ndëshkimore, të përdorura ndaj nxënësve që paraqesin çrregullime të sjelljes. NSP -të nuk janë një teori e re për sjelljen, por një qasje e një sistemi të bazuar në sjellje, për të nxjerrë në pah aftësinë e shkollës që të mundësojë mjedise të dobishme që favorizojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien cilësore. Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive ofrojnë një sistem me shumë nivele që funksionon për çdo nxënës. Duhet mbajtur parasysh se NSP-ja nuk është një trajtim ose terapi. Është një kornizë për t'u ndjekur nga mësuesit, drejtuesit dhe punonjësit e tjerë arsimorë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se kur një shkollë përdor NSP-të, ajo e përdor atë për të gjithë nxënësit e saj.

REKOMANDIMET

1. Bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe familjes të jetë i planifikuar - gjetjet e studimit dëshmojnë se ai duhet bëhet në të kundërt. Të realizohet bashkëveprimi ndërmjet shkollës dhe familjes në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.
2. Të planifikohen programe ndërgjegjësimi - tryeza dhe veprimtari të ndryshme sociale të cilat bëjnë që familja ta kuptojnë rëndësinë e përfshirjes dhe bashkëpunimit të saj me shkollën në parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve.
3. Për ato familje të cilat nuk janë pjesë e shkollës, të cilat mësuesi i takon rrallë ose aspak, rekomandojmë që përgjegjësia të bjerë mbi shkollën, sepse asaj i takon që në bashkëpunim me organet kompetente dhe ekspertët e arsimit, të gjejë mënyra për përfshirjen e kësaj kategorie familjesh në shkollë.
4. Shkolla, të organizojë trajnime, takime pune dhe veprimtari të tjera edhe për stafin e shkollës në drejtim të përgatitjes së tyre për rëndësinë e përfshirjes efikase të familjes në shkollë në tërë kompleksitetin e saj.
5. MASHT-i të organizojë programe trajnimi për mësuesit dhe drejtorët e shkollave për rëndësinë e përfshirjes së familjes në shkollë. Studimi ynë gjen mangësi në përceptimin e shkollës për bashkëpunim me familjen. Nuk mjafton vetëm vullneti dhe dëshira por të kryhet edhe përgatitja profesionale e mësuesve dhe drejtuesve të shkollës për përfshirjen dhe bashkëpunimin e tyre me familjen.
6. Rekomandimi i fundit në këtë drejtim por ndër të parët për nga rëndësia, është përfshirja e parandalimit të dhunës në kurrikulën mësimore, duke i ndërgjegjësuar kështu nxënësit për dhunën dhe pasojat e saj. Madje, ne si studiues e konsiderojmë këtë si ndër rekomandimet me përparësi për parandalim e dhunës ndërmjet nxënësve.

Referencat

- Association, A. E. (2013). Prevention of Bullying in Schools, Colleges, and Universities : Research Report and Recommendations.
- Burger, C., Strohmeier, D., Spröber, N., Bauman, S., & Rigby, K. (2015). How teachers respond to school bullying: An examination of self-reported intervention strategy use, moderator effects, and concurrent use of multiple strategies. *Teaching and Teacher Education*, 191-202.
- Beqiri, L. B. (2014). *Roli i shërbimit profesional ne shkollë*. Prishtine: Insituti pedagogjik i Kosoves.
- Brada, R. (2005). *Pedagjogjia Shkollore*. Prishtinë:
- Dervodeli, J. (2014). *Nevoja për shërbimin pedagogjik-psikologjik në shkollimin parauniversitar te Kosoves*. Prishtine: Insituti pedagogjik i Kosoves.
- Greenwood, M. M. (2000). You Can Cope with Your Children's Circumstances Which are About School. Istanbul, Sistem Publishing: Sistem Publishing.
- Ertugrul, A. D. (2000). *Njeriu qe kerkon veteveten* . Tirane: Arberia.
- Fullan, M. (2010). *Forcat e ndryshimit ne arsim*. Tirane: CDE.
- Hoti, D., Zabeli, N., Shahini, M., Arënlju, A., Gashi, L. J., Buleshkaj, O., et al. (2016a). *Vëllimi II puna e pedagogut të shkollës*. Prishtinë: Masht ; USAID ; fondacioni Zvicërran Terre des Hommes.
- Hoti, D., Zabeli, N., Shahini, M., Arënlju, A., Gashi, L. J., Buleshkaj, O., et al. (2016b). *Vëllimi i Shërbimi pedagogjik dhe psikologjik në shkollë*. Prishtinë: Masht ; USAID ; Fondacioni Zvicërran Terre des Hommes.
- Kerkime Pedagogjike*. (2014). Prishtine: Instituti Pedagogjik i Kosoves.
- Krasniqi, I., & Deva-Zuna, A. (2012). *Një shkollë pa dhunë (Si ta bëjmë)*. Prishtinë: Libri shkollor.

- Jani Thomai, M. S. (2004). *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Institucioni i Gjuhës dhe i Letërsisë.
- Javanaud, K. (2016, Jul 29). *Platforma për mbrojtjen e fëmijëve për Evropën Juglindore*. Retrieved from PASOJAT E DHUNËS NDAJ FËMIJËVE (RISHIKIM NGA CHILD HUB): <https://childhub.org/sq/online-biblioteka-o-djecijoj-zastiti/pasojat-e-dhunes-ndaj-femijeve-rishikim-nga-child-hub>
- Jonuzi, M. (2017). *Qasja institucionale ndaj dhunës në shkolla*.
- Kağıtçıbası, Ç. (2008). *Human and Human-Being* 11th Edition. Istanbul: Evrim Publishing.
- KIPRED. (2013). *Dhuna në shkolla*.
- Kraja, Dr. Musa . (2008): *Pedagogji e zbatuar*, Geer, Tiranë
- Kopka, D. L. (1997). *School Violence: A Reference Handbook*. Santa Barbara.
- Kopka, D. L. (1997). *School Violence: A Reference Handbook*. Santa Barbara, CA: ABC-CLIO.
- Larsen, E. (2003). *Violence in U.S. Public Schools: A Summary of Findings*. National Center for Education Statistics.
- Matthew, B. R. (2010). *Metodat e hulumtimit - udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*.
- Masht, & Instituti Pedagogjik i Kosovës, (2016). *Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë*. Prishtinë: Blendi.
- Manual didaktik për parandalimin e dhunës / Aliriza Arenliu ...[et al.]. – Prishtinë : Save the Children, 2014.
- Mertoglu, M. (2014). The Role of School Management in the Prevention of School. *Science Direct*, 701.
- Meyer Adams, N. (2008). School Violence: Bullying Behaviors and the Psychosocial School Environment in Middle Schools. 211-221.
- Nuredini, Vaxhid (1999). *Metodika e punës së pedagogut të shkollës-dokimologjia*. Prishtinë: Rilindja.
- Nushi, P. (. (1987). *Fjalor i psikologjisë*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.

OBSH. (2002). *World report on violence and health*.

Olweus, D. (1999). *The nature of school bullying: A cross-national perspective*. New York: Plenum.

Patrick, C. J. (2008). Psychophysiological correlates of aggression and violence: An integrative review. In *Philosophical Transactions of the Royal Society B: Biological Sciences* (pp. 2543–2555.).

THE WORK OF THE PEDAGOGUE: ROLES AND TASKS (2018). Danimarke. Retrieved from: https://bupl.dk/wp-content/uploads/2018/02/publikationer-the_work_of_the_pedagogue.pdf dhe https://bupl.dk/ep_content/uploads/2018/02/publikationerthe_öork_of_the_pedagogue.pdf?fbclid=IëAR24GZ-sËJcfEX-1MfYt75U5p1lz8jXGbBtf_CkERUëIf_T3B4mRQRjPHOM

Save the Children. (2017). Analiza mbi mekanizmat e përdorur për identifikimin dhe raportimin e dhunës në shkollë. Prishtinë.

UNESCO. (2017). School Violence and Bullying: Global Status Report. pp. 110-111.

UNICEF. (2005). *Hulumtim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovë*.

MASHT. (2014). *Doracak për parandalimin e dukurive negative në shkolla të mesme të larta*.

USAID Kosovo . (2008). *Summary report of opinions and recommendations of High School*.

William M. Kane, N. G.-C. (2012). *Violence & Injury Prevention: Health Facts*. California.

Shahini M, (2011). National Survey on Emotional and Behavioral Problems in Children 6-18 years old in Kosovo. Doctoral theses.

Children Now (2001). Fair play? Violence, gender and race in video games. Los Angeles, CA: Children Now.

Dietz, T. L. (1998). An examination of violence and gender role portrayals in video games: Implications for gender socialization and aggressive behavior. *Sex Roles*, 38, 425–442.

Dill, K. E., Gentile, D. A., Richter, W. A., & Dill, J. C. (2001). Portrayal of women and minorities in video games. Paper presented at the 109th Annual Conference of the

Anderson, C. A., & Dill, K. E. (2000). Video games and aggressive thoughts, feelings, and behavior in the laboratory and life. *Journal of Personality and Social Psychology*, 78, 772–790.

MASHT. (2012). Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (Klasa X, XI, XII) . Prishtinë: BKUK

<https://fshmt.umt.rash.al/wp-content/uploads/2017/10/MIRANDA-OSMANI.pdf>

Koliqi, Hajrullahu.2000. “Historia e arsimit shqiptar II”. Libri shkollor: Prishtinë.

Krasniqi, Islam & Zuna, Aferdita. 2012. “Një shkollë pa dhunë”. Libri Shkollorë: Prishtinë.

Qendra për Arsim. KIPRED. 2003. “Dhuna në shkolla”. Prishtinë: Gusht, Marrë nga:

http://www.kipred.org/repository/docs/DHUNA_N%C3%8B_SHKOLLA_914403.pdf

Sylaj, Vlora.2014. “Bashkëpunimi shkollë familje në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve

në shkollë”. Desertacioni i nivelit të doktoraturës. Universiteti i Tiranës. Marrë nga:

[http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/01/Doktoratura-Vlora-](http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/01/Doktoratura-Vlora-Sylaj-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Psikologji-Pedagogjise.pdf)

[Sylaj-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Psikologji-Pedagogjise.pdf](http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/01/Doktoratura-Vlora-Sylaj-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Psikologji-Pedagogjise.pdf)

Woolfolk, Anita.2011. Psikologji Edukimi. Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë.

Working together 2010. “An initiative of the Queensland School Alliance Against Violence”.

Universiteti i Prishtinës



UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovës

Tel: +381-38-244183 URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-244187 Mail: rektorati@uni-pr.edu

FAKULTETI I EDUKIMIT

Këshillit të Fakultetit të Edukimit

Kërkesë për lejimin e punimit të tezës së masterit

Propozim për tezën e masterit në programin “Pedagogji e përgjithshme ”

Emri dhe mbiemri i studentit: Behar Kryeziu

Data e dorëzimit të kërkesës: .09/2020

Emri dhe mbiemri i mentorit: Januz Dërvodeli

Titulli i propozuar i tezës së masterit: Roli i pedagogut dhe organeve drejtuese në parandalimin e dukurive negative në shkolla e mesme të ulta dhe të larta

Nënshkrimi i mentorit/es:

Nënshkrimi i studentit/es:

Shtojca-instrumentet e hulumtimit-pyetësorët

Pyetësor për mësimdhënësit

Të nderuar mësimdhënëses,

Pyetësori i mëposhtëm shërben për të evidentuar mendimet tuaja lidhur me identifikimin e faktorëve pse nxënësit shfaqin sjellje të dhunshme në shkolla. Ju jeni zgjedhur si një person i përshtatshëm për plotësimin e këtij pyetësori.

Ju lutem plotësoni pyetësorin në mënyrë sa më të sinqertë. Informacioni që ju do të jepni do të ngelet plotësisht anonim. Ky pyetësor do të shfrytëzohet për mbrojtjen e temës së masterit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” nga kandidati Behar Kryeziu.

1) Gjinia: (rretho) M F

2) Moshë:

3) Vendi:(rretho) a). Fshat b). Qytet

4) Shkollimi: (kualifikimi juaj – rretho)

a).ShLP b).Fakultet c).Specializimprofesional d).Magjistraturë e).
Doktoraturë

5) Sa nxënës ka shkollajuaj?

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem fare
1. Në shkollën time mbretëron atmosferë e këndshme pune- mësimi					
2. Raportet në mes të mësimdhënësve dhe nxënësve janë të shkëlqyera					
3. Në ditët e sotme , nxënësit nuk i respektojnë mësimdhënësit e tyre					
4. Nxënësit nuk frikësohen nga askush në shkollë					
5. Mungesa e pedagogut dhe psikologut në shkollë ka ndikuar në rritjen e sjelljeve të dhunshme tek nxënësit					
6. Në shkollën tonë mbretëron tolerancë e tepruar ndaj nxënësve					
7. Fëmijët e dhunshëm vinë të tillë nga familja					
8. Sjellje të dhunshme zakonisht shfaqin ata nxënës që e kanë të dhunshme edhe familjen					
9. Stili prindëror i edukimit ka rëndësi që këta fëmijë shfaqin sjellje të dhunshme					
10. Fëmijët duhet të frikësohen nga ndëshkimi fizik sepse zvogëlohen sjelljet e dhunshme në shkollë					

11. Në të shumtën e rasteve ndëshkimi fizik , në qoftë se bëhet në mënyrë korrekte, ka efekte pozitive në edukimin e nxënësve					
12. Njoh mësimdhënës që ushtrojnë dhunë ndaj nxënësve në shkollë					
13. Shumica e problemeve me nxënësit mund të zgjidhen duke biseduar					
14. Nxënësit duhet të ndëshkohen nëse sillen dhunshëm me të tjerët					
15. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse i ngacmon të tjerët					
16. Nxënësit duhet të ndëshkohen nëse i kanë thyer rregullat e shkollës					
17. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse ikën nga ora mësimore					
18. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse nuk e dëgjon mësimdhënësin					
19. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse nuk e dëgjon drejtorin					
20. Nxënësi duhet të ndëshkohet nëse nuk e dëgjon kujdestarin e ditës					

Sa mendoni se shprehjet e mëposhtme janë shkaktarë për shfaqjen e dhunës në shkollë? Shprehni mendimin tuaj me X në shkallën e mëposhtme:

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Aspak nuk ndikon	Pak ndikon	Ndonjëherë ndikon	Ndikon mesatarisht	Shumë ndikon	Gjithmonë ndikon
1. Familja e çorganizuar						
2. Mbikëqyrja e dobët e familjes						
3. Liria e tepërt e fëmijëve nga prindërit						
4. Mënyra e edukimit të fëmijës						
5. Paaftësia për t'i përmbushur detyrat prindërore						
6. Marrëdhëniet e dobëta prindër- fëmijë						
7. Prindërit abuzivë						
8. Gjendja ekonomike e dobët e familjes						
9. Fëmijët e abuzuar, abuzojnë të tjerët						
10. Mësimdhënësit e pasjellshëm						
11. Drejtorët e rreptë						
12. Mos respektimi i rregullave të caktuara në shkollë						
13. Shokët dhe shoqet me sjellje të dhunshme						
14. Mësimdhënësit e dhunshëm						
15. Jo kontroll i mirë i nxënësve ndaj sjelljes në shkollë						
16. Interneti shans për sjellje të dhunshme						
17. Lojërat e dhunshme kompjuterike						
18. Numri i madh i nxënësve në klasa						
19. Lagjia ku jeton						
20. Menaxhimi i dobët i shkollës						

Pyetësi për prindër

Të nderuar prindër,

Pyetësi i mëposhtëm shërben për të evidentuar mendimet tuaja lidhur me identifikimin e faktorëve, pse nxënësit shfaqin sjellje të dhunshme në shkollë.

Ju jeni zgjedhur si një person i përshtatshëm për plotësimin e këtij pyetësi.

Ju lutem plotësoni pyetësin në mënyrë sa më të sigurtë. Informacioni që ju do të jepni do të mbetet plotësisht anonim. Ky pyetësor do të shfrytëzohet për mbrojtjen e temës së masterit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” nga kandidati Behar Kryeziu.

1) Gjinia:(rretho) M F

2) Moshë: _____

3) Familja juaj jeton (rretho) :a) Fshat b) Qytet
4) Banoni në:(rretho) a) Qendër të qytetit b) Periferi

5) Numri i anëtarëve në familje: a) 3 anëtarë, b) 4-6 anëtarë, c) Më shumë se 6 anëtarë

6) Jetoni me bashkëshortin-ten:(rretho) a) Së bashku b) Të ndarë

7) A jeni të punësuar? PoJo

8) A është i punësuar bashkëshorti-ja? PoJo

9) Të ardhurat në familje në muaj:

a) Të shkëlqyeshme, b) Të mira, c) Të mjaftueshme, d) Të vështira

10) Shkollimi i juaj: (kualifikimi – rretho)

a) Shkollë Filllore, b) Mesme c) ShLP, d) Fakultet, e) Magjistraturë f) Doktoraturë

11) Shkollimi i bashkëshortit-tes tuaj: a) Shkollë Filllore, b) Mesme c) ShLP, d) Fakultet, e) Magjistraturë f) Doktoraturë

10) Sa kohë në ditë kalon fëmija juaj në internet?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

11) Sa kohë në ditë kalon fëmija juaj duke shikuar TV?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

12) Sa kohë fëmija juaj kalon me shokë dhe shoqe jashtë mësimit?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

14) Sa kohë fëmija juaj kalon me familjen në ditë?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem fare
1. Në familjen time mbretëron atmosferë e këndshme					
2. Në familjen time vendosim së bashku me bashkëshortin time					
3. Fjalën kryesore në familje e kam unë					

4. Fëmijët e mi më lehtë brengat e tyre i shprehin me nënën					
5. Fëmijët e mi më lehtë brengat e tyre i shprehin me babain					
6. Prindërit kanë të drejtë të qëllojnë fëmijën e tyre					
7. Ai që e qëllon fëmijën, i do të mirën atij/asaj					
8. Fëmija po nuk u frikësua, nuk edukohet dot					
9. Nëse nuk e godet fëmijën, ai do të dal duarsh					
10 . Nëse fëmijës i flet dhe nuk të bindet,atëherë duhet goditur					
11. Një fëmijë i mirë,i bindet gjithmonë prindit të tij					
12. Fëmija mund të qëllohet por vetëm më ndonjë shuplakë të lehtë					
13. Fëmijët nuk kuptojnë me fjalë, prandaj duhet qëlluar					
14. Ndëshkimi fizik (të qëlluarit, rrahja) është mënyrë e mirë disiplinimi					
15. Druri të bën njeri					

16. Nënës i lejohet më shumë se babait të godasfëmijën					
17. Djalin mund ta qëllosh po nuk t'u bind					
18. Vajzën nuk duhet goditur sepse është e brishtë dhe mund tëlëndohet					
19. Në ditët e sotme ka më shumë grindje ndërmjet motrave dhe vëllezërve					
20. Unë si prind e qortoj fëmijën nëse ka qenë i dhunshëm më fëmijët e tjerë					
21. Fëmija ballafaqohet dhe i kalon vështirësitë vetë pa u konsultuar me ne si prindër					
22. Fëmijën e mbikëqyri në çdo kohë					
23 .Shpesh zihem me fëmijën sepse nuk e dëgjon fjalën time					
24. Unë e kritikoj fëmijën tim nëse qëndron në internet shumë					

25. Unë e kritikoj fëmijën tim nëse shikon filma shumë					
26. Unë ia përcaktoj fëmijës se me kënd të shohërohet					

Sa mendoni se shprehjet e mëposhtme janë shkaktarë për shfaqjen e dhunës në shkollë.
Shprehni mendimin tuaj me X në shkallën e mëposhtme:

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Aspak nuk ndikon	Pak ndikon	Ndonjëherë ndikon	Ndikon mesatarisht	Shumë ndikon	Gjithmonë ndikon
1. Familja e çorganizuar						
2. Mbikëqyrja e dobët e familjes						
3. Liria e tepërt e prindërve						
4. Mënyra e edukimit të fëmijës						
6. Marrëdhëniet e dobëta prindër-fëmijë						
7. Prindërit abuzivë						
8. Gjendja ekonomike e dobët e familjes						
9. Fëmijët e abuzuar ,abuzojnë të tjerët						
10. Mësimdhënësit e pasjellshëm						
11. Drejtorët e rreptë						
12. Kur shkolla nuk ka rregulla të caktuara						
13. Shokët dhe shoqet me sjellje të dhunshme						
14. Mësimdhënësit e dhunshëm						
15. Jo kontroll i mirë ndaj tyre në shkollë						
16. Interneti shans për sjellje të dhunshme						
17. Lojërat e dhunshme kompjuterike						
18. Numri i madh i nxënësve në klasa						
19. .Lagjja ku jeton						
20. Menaxhimi i dobët i shkollës						

Pyetësor për nxënës

Të dashur nxënës,

Pyetësori i mëposhtëm shërben për të evidentuar mendimet tuaja lidhur me identifikimin e faktorëve, pse nxënësit shfaqin sjellje të dhunshme në shkolla.

Ju jeni zgjedhur si një person i përshtatshëm për plotësimin e këtij pyetësori.

Ju lutem plotësoni pyetësorin në mënyrë sa më të sinqertë. Informacioni që ju do të jepni do të mbetet plotësisht anonim. Ky pyetësor do të shfrytëzohet për mbrojtjen e temës së masterit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” nga kandidati Behar Kryeziu.

1) Gjinia:(rretho) M F

2) Mosha (rretho): a) 13 vjeç, b) 14 vjeç c) 15 vjeç

3) Familja juaj jeton (rretho) :a)Fshat b) Qytet

4) Banoninë: (rretho)

a) Qendërtëqytetit b)Periferi

5) Numri i anëtarëve në familje: a) 3 anëtarë, b) 4-6 anëtarë, c) Më shumë se 6anëtarë

6) Prindëritjetojnë:(rretho) a) Së bashku b) Të ndarë

7) A janë të punësuarprindërit:

BabaiPO JO

Nëna PoJO

8) Të ardhurat në familjen tuaj nëmuaj:

a) Të shkëlqyeshme,b) Të mira, c) Të mjaftueshme, d) Të vështira

9) Shkollimi i prindërve: (kualifikimi – rretho)

Babai: a) Shkollë Fillore, b) Mesme c)ShLP, d) Fakultet, e) Magjistraturë f)Doktoraturë

Nëna: a) Shkollë Fillore, b) Mesme c)ShLP, d) Fakultet, e) Magjistraturë f)Doktoraturë

10) Sa nxënës jeni në klasë? (rretho):

a) Deri 25 nxënës b) Prej 25-30 nxënës c) Mbi 30 nxënës

11) Sa kohë kaloni në ditë në: Internet?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

12) Sa kohë kaloni duke shikuar TV?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

13) Sa kohë kaloni me shokë dhe shoqe jashtë mësimit?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

14) Sa kohë kaloni me familjen në ditë?

a) Më pak se një orë b) 2-3 orë në ditë c) Më shumë se 3 në ditë d) Nuk e di

14) Sa nxënës të shkëlqyer ka klasa juaj?

15) Sa nxënës të dobët ka klasa juaj?

Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem fare
1. Në shkollë shkoj me dëshirën më të madhe					
2. Shpesh ndihem i kërcënuar në shkollë nga nxënësit e tjerë					
3. Shpesh nxënësit më kanë shtyrë, dhënë shuplaka, pickuar ose edhe shqelmuar					
4. Shpesh në shkollë nxënësit më kanë marrë sendet e mia					
5. Shpesh nxënësit në shkollë m'i kanë grisur librat dhe fletoret					
6. Shpesh nxënësit më kanë dhënë komplimente seksuale					
7. Shpesh shokët janë më të dhunshëm fizikisht se shoqet					
8. Shoqet shpesh më ngacmojnë me fjalë fyese					
9. . Mësimdhënësit shpesh sillen padrejtësisht me mua					
10 . Shpesh mësimdhënësit më thonë fjalë fyese					
11. Shpesh mësimdhënësit me tërheqin veshin ose më rrahin					
12. Në shkollë nuk di kujt t'i drejtohem për padrejtësitë					

13. Drejtori ushtron dhunë mbi nxënësit					
14. Rojet(sigurimi) ushtrojnë dhunë mbi nxënësit					
15. Nga e kaluara kujtoj se edhe mësuesja më ka goditur ose dënuar					
16. Shpesh bëhem nervoz dhe humb gjakftohtësinë					
17. Përballem shpesh me shokët për shkak të paqartësive					
18. Shpeshherë jam ndier keq për gjendjen ekonomike të familjes					
19 . Nëse në shkollë më akuzojnë për diçka,nga prindërit kam përkrahje					
20. Nëse në shkollë më akuzojnë për diçka,nuk guxoj t'i tregoj familjes					
21. Nëse në shkollë më akuzojnë për diçka, e fsheh nga ata sepse mund të më dënojnë					
22. Ndihem më lirë të shpreh brengat e mia me shokët dhe shoqet se me familjarët e mi					
23. Familja më ndërhyt maksimalisht në punët e mia					
24 . Më duhet t'ju jap llogari çdo ditë familjes					
25 Shpesh ndihem i pakënaqur me familjen					
26. Familja konsultohet çdo javë me mësuesin e mi					
27. Familja më dënon nëse sillem keq në shkollë					
28. Familja më mbikëqyrin në çdo kohë					
29. Shpesh zihem me prindërit sepse nuk mi plotësojnë nevojat e mia					
30. Babait ia kam frikën më shumë					
31. Nënës ia kam frikën më shumë					
32. Motra shpesh më ofendon dhe më thërret me nofka					
33. Vëllai më lehtë më qëllon sesa motra					
34. Zakonisht vëllezërit godasin motrat e tyre					
35. Zakonisht motrat i fyejnë vëllezërit					
36. Prindërit më kritikojnë se po qëndroj në internet shumë					
37. Prindërit më kritikojnë se po shikoj filma shumë					
38. Prindërit e mi më ndërhyjnë edhe në shoqëri se me cilin- cilën të shoqërohem					

Sa mendoni se shprehjet e mëposhtme janë shkaktarë për shfaqjen e dhunës në shkollë. Shprehni mendimin tuaj me X në shkallën e mëposhtme:

Sa jeni dakord me pohimet e më poshtme	Aspak nuk ndikon	Pak ndikon	Ndonjëherë ndikon	Ndikon mesatarisht	Shumë ndikon	Gjithmonë ndikon
1. Familja e çorganizuar						
2. Mbikëqyrja e dobët e familjes						
3. Liria e tepërt e prindërve						
4. Mënyra e edukimit të fëmijës						
5. Paaftësia për t'i përmbushur detyrat prindërore						
6. Marrëdhëniet e dobëta prindër-fëmijë						
7. Prindërit abuzivë						
8. Gjendja ekonomike e dobët e familjes						
9. Fëmijët e abuzuar ,abuzojnë të tjerët						
10. Mësimdhënësit e pasjellshëm						
11. Drejtorët e rreptë						
12. Kur shkolla nuk ka rregulla të caktuara						
13. Shokët dhe shoqet me sjellje të dhunshme						
14. Mësimdhënësit e dhunshëm						
15. Jo kontroll i mirë ndaj tyre në shkollë						
16. Interneti shans për sjellje të dhunshme						
17. Lojërat e dhunshme kompjuterike						
18. Numri i madh i nxënësve në klasa						
19 .Lagjja ku jeton						
20. Menaxhimi i dobët i shkollës						